

## **Bashkimi Evropian**

# **Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut Kosovë**

## **Raport vjetor**

**1 janar - 31 dhjetor 2015**

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati**

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Email: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)



## Përmbajtja

Parathënie.....	5
1. Hyrje.....	7
2. Korniza rregulluese .....	8
2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË .....	8
2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	8
2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut .....	9
3. Paneli dhe Sekretariati.....	9
3.1. Anëtarët e Panelit.....	9
3.2. Sekretariati .....	12
4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave .....	13
4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat .....	13
4.2. Trendët .....	14
4.3. Subjekti i ankesave .....	14
5. Jurisprudenca.....	15
5.1. Meritat.....	15
5.1.1. <i>X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it</i> .....	15
5.1.2. <i>Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it</i> .....	17
5.1.3. <i>K, L, M, N, O, P, Q, R, S &amp; T (K deri në T) kundër EULEX-it</i> .....	18
5.1.4. <i>Fitim Maksutaj kundër EULEX-it</i> .....	19
5.1.5. <i>L.O. kundër EULEX-it</i> .....	20
5.2. Pranueshmëria .....	22
5.2.1. Lëndët e personave të vrarë dhe të zhdukur.....	22
5.2.2. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave të Kosovës .....	23
5.2.3. Kompetenca e Panelit për të shqyrtuar veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it .....	23
5.3. Vendimet pasuese .....	24
6. Aktivitetet e Panelit .....	24
6.1. Fushata informuese e vitit 2015.....	24
6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it .....	25
6.3. Faqja e internetit e PShDNj-së.....	26
7. Çështjet operative/administrative.....	26
7.1. Buxheti.....	26
7.2. Personeli i Sekretariatit .....	26
8. Komentim ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut dhe çështjet që lidhen me to në Kosovë.....	26

8.1.	Pjesë e shkëputur e raportit të Grupit Punues, Këshillit të të Drejtave të Njeriut, Kombeve të Bashkuara rreth zhdukjeve me forcë apo të pavullnetshme, Asambleja e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, 17 gusht 2015 .....	26
8.2.	Prezantimi publik dhe Analiza e vendimeve të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut - Përgjegjësia e Kombeve të Bashkuara (UNMIK-ut) për Zhdukjet me forcë dhe vrasjet e serbëve në Kosovë .....	35
8.3.	Pjesë e shkëputur nga Raporti i Human Rights Watch i vitit 2016 rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.....	36
8.4.	Pjesë e shkëputur nga një disertacion me titull “Përgjegjësia ndërkombëtare rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e organizatave ndërkombëtare në situatat pas konfliktit. Mësimet nga Kosova” .....	37
9.	Konkluzione.....	39
SHTOJCA 1	Tabela e personelit.....	42
SHTOJCA 2	Statistikat 2010 - 2015 .....	43
SHTOJCA 3	Vendimet e PShDNj-së 2010-2014 .....	44
SHTOJCA 4	Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera .....	52

## Parathënie

Ky është raporti i gjashtë vjetor i Panelit që mbulon periudhën 1 janar 2015 - 31 dhjetor 2015. Gjatë periudhë raportuese Paneli ka mbajtur pesë seanca dhe ka kryer një fushatë informuese në një udhëtim në Serbi.

Paneli ka shqyrtuar 38 ankesa dhe 15 ankesa të reja janë parashtruar në Panel.

Paneli ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut në katër raste dhe ka shpallur se nuk ka pasur shkelje në dhjetë të tjera. Po ashtu ka shpallur tetë raste të pranueshme, pa paragjykuar meritat e tyre.

Paneli ka dhënë vendime pasuese në dy rastet ku ishin gjetur shkelje më parë.

Përveç kësaj, 12 raste janë shpallur të papranueshme dhe një është hequr nga lista e lëndëve.

Paneli ka vazhduar të zhvilloj jurisprudencën e vet gjatë shqyrtimit të rasteve që *ndër të tjera* kanë të bëjnë me nenet 2, 3, 6, 8, 13 dhe nenin 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Paneli dhe Sekretariati po ashtu kanë vazhduar me fushatën e vet informuese. Sekretariati i shoqëruar nga një anëtar i Panelit është takuar me koordinatorin e Zyrës për Kosovë dhe Metohi, në veri të Mitovicës me datën 16 qershor.

Në përbërje të plotë Paneli i shoqëruar nga Sekretariati me 7 dhjetor është takuar me shefin e Grupit për Drejtësi, të Drejta të Njeriut dhe të Drejta në Pronësi, Zyra për Kosovë dhe Metohi, këshilltarin, Departamenti i Çështjeve Ligjore, Zyra për Kosovë dhe Metohi dhe kryetarin e Komisionit për Persona të Zhdukur, dhe koordinatorin, Zyra për Persona të Zhdukur, Qeveria e Republikës së Serbisë në Beograd.

Paneli është takuar në Beograd me 7 dhe 8 dhjetor edhe me udhëheqësin e ekipit dhe zëvendës udhëheqësin e ekipit të agjencisë për zbatimin e projektit për mbështetje të mëtutjeshme për refugjatët dhe persona të zhvendosur brenda vendit në Serbi, (Europaid/129209/C/SER/RS), projekt i financuar nga BE-ja.

Funksionimi i Panelit (përfshirë fushatën informuese) ishte ngadalësuar për një periudhë kohore për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore. Paneli ka funksionuar me vetëm një zyrtar ligjor për rreth katër muaj, dy zyrtarë ligjorë për rreth tre muaj dhe me tre zyrtarë ligjorë për vetëm pesë muaj të vitit.

Pavarësisht nga përpjekjet më të mira gjatë fushatës informuese, ekziston një mungesë e vazhdueshme e njohjes së mandatit, procedurave dhe operimeve të Panelit në zonën ku vepron Misioni. Paneli është i vendosur ta trajtoj këtë problem gjatë vitit 2016, me mbështetjen e EULEX-it, *ndër të tjera* me rifillimin një fushate informimi në TV, e cila fillimisht kishte nisur në vitin 2014.

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar takimet e tyre periodike me zyrtarë të lartë të EULEX-it. Një prezantim i plotë nga Paneli dhe Sekretariati i është dhënë shefit të ri të stafit, z. John Rouse. Përveç kësaj, Paneli dhe Sekretariati i kanë bërë një prezantim shefit të Policisë Ekzekutive të EULEX-it dhe stafit të tij që u pasua me një diskutim të thellë mbi rolet dhe përgjegjësitë e EULEX-it dhe të Panelit.

Përmes punës dhe aktiviteteve të tij, Paneli vazhdon të përmirësoj më gjerë mandatin e EULEX-it Kosovë, *ndër të tjera* në ofrimin e mjeteve juridike kuptimplote ligjore, mbështetje dhe ndihmë ndaj qytetarëve në përgjithësi, të cilët besojnë se të drejtat e tyre të njeriut janë shkelur nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Ekzistenca dhe puna e Panelit dërgon porosi të qartë rreth angazhimit të Misionit për zbatimin e standardeve të larta të të drejtave të njeriut përgjatë aspekte të ndryshme të mandatit të tij ekzekutiv.

Nga ana administrative, kam kënaqësinë që t'i uroj mirëseardhje zyrtarit tonë të ri ligjor, Paul Landers, i cili në gusht mori postin e tij në Panel. Përfitoj nga ky rast t'i uroj atij çdo sukses në detyrën e tij sfiduese.

Së fundi, do të doja ta vlerësoj zbatimin e rekomandimeve të Panelit nga ana e shefit të Misionit të EULEX-it, aty ku është gjetur se EULEX-i Kosovë kishte bërë shkelje të të drejtave të njeriut (shih më poshtë – referoju vendimeve përkatëse në tekst). Është thelbësore që të sigurohet efikasiteti i punës së Panelit që shefi i Misionit dhe stafi i tij duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë për të vazhduar ndërtimin e një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë dhe respektit për sundimin e ligjit në kuadër të Misionit. Do të dëshiroja të shfrytëzoj këtë mundësi për të paraqitur vlerësimin tonë lidhur me bashkëpunimin e mirë që Paneli ka pasur deri më tani nga shefi i Misionit dhe personeli i tij në selinë e EULEX-it Kosovë.

Magda Mierzevska  
Kryesuese  
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## 1. Hyrje

Bashkimi Evropian ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje si: Paneli) me 29 tetor 2009 me mandatin për shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.

Paneli është i pari dhe deri më tani mekanizmi i vetëm llogaridhënës i të drejtave të njeriut që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga një mision i Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes të Bashkimit Evropian.

Së bashku me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), Paneli është një prej vetëm dy Paneleve ndërkombëtare që mbajnë përgjegjëse organizatat ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut.

Zgjerimi i llogaridhënies për shkeljet e të drejtave të njeriut prej shteteve tek organizatat ndërkombëtare paraqet një përparim të madh në zhvillimin e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që merr peshë të madhe ndërkombëtare. Mundet që në momentin e duhur të përbëjë një element të domosdoshëm të punës së organizatave ndërkombëtare, e në veçanti i misioneve për sundimin e ligjit, atëherë kur kryejnë disa prej funksioneve ekzekutive të një shteti.

Gjatë këtij viti, Paneli ka shqyrtuar 38 ankesa dhe ka gjetur se EULEX-i ka bërë shkelje të drejtave të njeriut në katër raste. Në dy raste, shkeljet ishin rreth një dështimi për të vepruar nga ana e EULEX-it në kundërshtim me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) (e drejta për zgjidhje efektive). Në një tjetër, Paneli konstatoj se të drejtat e ankuesit sipas nenit 6 ishin shkelur (E drejta për gjykim të drejtë). Vendimi në rastin e katërt ka gjetur shkelje të shumëfishta të neneve 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i torturës), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës në lidhje për hetimet joadekuatë rreth rrëmbimeve, zhdukjeve dhe vrasjeve në Kosovë në vitin 1999 dhe 2000.

Në dhjetë raste, Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës.

Duke vepruar sipas rregullës 34 dhe rregullës 45 *e tutje* të rregullores së tij të punës, Paneli ka bërë rekomandime të hollësishme korrigjuese për shefin e Misionit të EULEX-it në lidhje me shkeljet që i kishte gjetur dhe ka vlerësuar reagimin pasues nga ana e EULEX-it Kosovë rreth rekomandimeve të tij.

Paneli ka shpallur 12 ankesa të papranueshme dhe ka hequr një ankesë nga lista e ankesave.

Gjithsej 15 ankesa të reja janë parashtruar në Panel gjatë periudhës raportuese.

Paneli ka vazhduar me fushatën informuese, ku përpjekja kryesor është përqendruar në OJQ-të, aktive në fushën e të drejtave të njeriut, përfaqësues të shoqërisë civile dhe autoritetet vendore dhe akterët në nivelin komunal. Sekretariati gjithashtu ka marrë pjesë në seminare të ndryshme, konferenca dhe tryeza të rumbullakëta lidhur me të drejtat e njeriut.

Diskutimet dhe ndërveprimet e Panelit me bashkëbisedues dhe organizata joqeveritare në zbatimin e fushatës informuese në zonën ku vepron misioni ka rritur profilin e EULEX-it Kosovë dhe me gjerë ka rritur po ashtu reputacionin dhe kredibilitetin e tij në gjithë zonën e misionit dhe më tej.

Angazhimi i Panelit në këto diskutime dhe aktivitete të fushatës informuese po ashtu demonstroi vendosmërinë e Bashkimit Evropian (BE-së) në një mision të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikave të Mbrojtjes për të adresuar shqetësimet lidhur me të drejtat e personave serbë të Kosovës të zhvendosur brenda vendit, të cilët në këtë rast aktualisht janë të zhvendosur në Serbi dhe në vende të tjera, në lidhje me çështjet e personave të vrarë dhe të zhdukur, si dhe të drejtave/kontesteve pronësore.

Për më tepër, përpjekjet e Panelit në këtë drejtim çojnë përpara dhe nxjerrin në pah publikisht dëshminë konkrete rreth angazhimit të BE-së për të siguruar llogaridhënie për shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv.

Këto aktivitete të fushatës informuese më tej i mundësojnë Panelit që t'i informoj qytetarët në përgjithësi në lidhje me disponueshmërinë e një mjeti juridik për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë dhe të rris informimin e qytetarëve rreth të drejtave të njeriut në zonën e misionit.

Më e rëndësishmja, ky ndërveprim nga Paneli me personat të cilët janë të angazhuar në programet e ndihmës juridike, etj. në zonën e misionit, lehtëson qasjen në drejtësi dhe siguron mbështetje tjetër ndaj atyre që të drejtat e njeriut supozohet se iu janë shkelur nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.

Më në fund, pavarësisht prej përpjekjeve të mëdha në zbatimin e fushatës informuese, me burime të kufizuara njerëzore, Paneli pranon se ka një mungesë të heshtur të informimit rreth mandatit, procedurave dhe punës së Panelit në zonën e misionit.

Paneli ka për qëllim ta adresoj këtë problem gjatë vitit 2016, me mbështetjen e EULEX-it, ndër të tjera me rifillimin një fushatë informimi në TV, e cila mjaft suksesshëm kishte nisur për herë të parë në vitin 2014.

## **2. Korniza rregulluese**

### **2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË**

Veprimi i Përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencës së misionit të EULEX-it në Kosovë. Ai përcakton mandatin e EULEX-it dhe ndër të tjera saktëson llogaridhënien e tij lidhur me të drejtat e njeriut në nenin 3 (i): *“të sigurohet që të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore”*.

### **2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009**

Krijimi i një mekanizmi efektiv dhe transparent i të drejtave të njeriut është cilësuar të jetë një nevojë thelbësore për EULEX-in Kosovë, si Mision për Sundimin e ligjit, të cilit u janë dhënë disa funksione të kufizuara ekzekutive. Një mekanizëm i tillë i jashtëm llogaridhënës do të shërbej për të plotësuar llogaridhënien e përgjithshme të EULEX-it në Kosovë, siç ofrohet nga Polica e Sigurimeve të Përgjegjësishë ndaj Palës së Tretë dhe nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it, të cilat janë themeluar që në fillim.



Në këtë mënyrë, Koncepti llogaridhënës përcakton mandatin e Panelit për të shqyrtuar ankesat nga secili person, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë<sup>1</sup>. Sidoqoftë, sipas këtij Koncepti, Paneli nuk ka juridiksion mbi gjykatat e Kosovës. Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës (për më shumë hollësi shih par. 5.2.1 më poshtë).

Paneli ka miratuar Rregulloren e vet të Punës me datën 10 qershor 2010, prej kur edhe është autorizuar të pranoj ankesa. Paneli ka ndryshuar rregullat e veta me 21 nëntor 2011 dhe me 15 janar 2013.

### **2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**

Sipas dispozitave të Konceptit llogaridhënës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e dyshuara, në mesin e të tjerave edhe të këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (KDCP, 1966)
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (KDEShK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat e Fëmijës (KDF, 1989)

Në praktikë, ankesat e parashtruara deri më tani kryesisht janë bazuar në nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj. Një numër i tyre gjithashtu janë bazuar në dispozitat e Deklaratës për të Drejtat e Njeriut, Konventat ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera të të drejtave të njeriut.

## **3. Paneli dhe Sekretariati**

### **3.1. Anëtarët e Panelit**

Paneli përbëhet prej katër anëtarëve, përfshirë kryesuesen e Panelit. Një prej anëtarëve të Panelit është po ashtu gjykatëse e EULEX-it.

#### **Kryesuesja**

**Znj. Magda Mierzewska**, shtetase e Polonisë, ka mbaruar Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistratit të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

---

<sup>1</sup> Koncepti llogaridhënës është pjesë e planit operativ të EULEX-it. Për këtë arsye konsiderohet një dokument i kufizuar dhe kështu nuk është i hapur për publikun.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo është punësuar si juriste në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të të drejtave të njeriut.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzevska përfshijnë: *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit*, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Popullariteti i Konventës në Poloni* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; *Dhjetë vjet më pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante* (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; *Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane*, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; *Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008; *Konsistenca e praktikës gjyqësore si çështje e të drejtave të njeriut në jurisprudencën e Gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut*, në: *Cohérence et impact de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme*, Liber amicorum Vincent Berger, 2013. Ajo është bashkë autore me J. Krzyzanowski, *Według ojca, według córki* e (Sipas babait, sipas vajzës), e cila ka marrë një çmim për librin më të mirë historik të botuar në Poloni në vitin 2010.

## **Anëtarët**

### **Prof. Dr. Guenaël Mettraux**

Dr. Guénaël Mettraux ka diplomuar për juridik (licence en droit) në Universitetin e Lozanës (Zvicër), ka magjistruar për juridik (LLM) në të drejtën ndërkombëtare nga Kolegji Universitar i Londrës dhe ka doktoruar në Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike.

Ai punon avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdamin (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut (Zvicër).

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial (Perspektiva rreth Gjykimit të Nyrembergut)* (Oxford University Press, 2008) dhe *The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese)* (Oxford University Press, 2009), e cila ka marrë çmimin Lieber nga *American Society of International Law (Shoqata Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare)*. Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Ndërkombëtare* dhe i Këshillit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Penale Ndërkombëtare*.

### **Dr. Katja Dominik**

Dr. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar drejtësinë dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996.

Dr. Domenik ka marrë bursë pasdiplomike, ku ka përfunduar studimet rreth aspekteve ligjore të shpërbërjes së shtetit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci, në vitin 1998/99. Disertacioni i saj ishte botuar në vitin 2001.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë, e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo ishte punësuar nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku kishte punuar në Divizionin për politikë zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, Dr. Domenik është emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Dyseldorf, ku është specializuar në lloje të ndryshme të ligjit penal. Më pas, ajo ishte bërë zëvendëse kryetare në dhomën penale të Gjykatës së Qarkut për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike.

Dr. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX Kosovë në tetor të vitit 2011, ku më pas është caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të profilit të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Shefi i misionit të EULEX-it ka emëruar dr. Domenik-un anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2013.

## **Anëtarja zëvendësuese**

### **Znj. Elka Filcheva-Ermenkova**

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase e Bullgarisë ka studiuar për drejtësi në Universitetin e Blagoevgrad-it në Bullgari, ku ka diplomuar në vitin 1997. Ajo është përqendruar në studimet e të drejtave të njeriut gjatë shkallës së masterit dhe më vonë ka përfunduar kurse të shumta lidhur me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollin e saj. Pas përfundimit të stazhit të saj pas-universitar, në tetor 1998 ajo është emëruar gjykatëse e re në Gjykatën e Qarkut në Blagoevgrad në një panel të ankimit, ku nën mbikëqyrjen e dy gjykatësve të Gjykatës së Qarkut ajo ka kryesuar lëndë në të gjitha prej këtyre çështjeve: civile, të së drejtës penale dhe administrative. Në vitin 2001 ajo është emërua gjykatëse në Gjykatën Rajonale të Ligjit në Blagoevgrad ku ka kryesuar çështjet civile dhe penale. Në vitin 2003 ajo është emëruar kryetare e Gjykatës Rajonale në Blagoevgrad.

Në vitin 2004, ajo është emëruar gjykatëse e Gjykatës së Qarkut në shkallën e dytë, ndërsa ka punuar edhe si gjykatëse e shkallës së parë dhe gjykatëse e apelit në çështjet civile dhe penale, me theks kryesor në çështjet civile.

Në janar të vitit 2008, ajo është dërguar në Këshillin e Bashkimit Evropian (BE), në departamentin për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale (PCMO) si këshilltare për sundim të ligjit, ku ka punuar deri në janar të vitit 2012. Në vitin 2012 ajo ishte emëruar gjykatëse ndërkombëtare në Gjykatën Supreme të Kosovës, ku nga janari 2012 deri në korrik 2014 ka punuar vetëm në kontestet pronësore që kanë të bëjnë me luftën dhe që nga gushti 2014 ajo merret me rastet penale që kanë të bëjnë me krimet e luftës, krim të organizuar dhe krime të tjera të rënda. Ajo është emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian nga shefi i Misionit të EULEX-it me 15 janar 2013.

### 3.2. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari të lartë ligjor, dy zyrtarë ligjor, një asistente administrative/gjuhësore dhe dy interpret/përkthyes.

**Z. John J. Ryan**, shtetas i Irlandës, ka diplomuar në juridik me titullin Bachelor (Hons) për Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat në Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timor lindor, Nepal, Kosovë dhe në Komisionin Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme, kishte punuar në UNMIK, *ndër të tjera* si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, zëvendës këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (O/PSSP). Në pozitën e tanishëm ai është emëruar zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së në prill 2010. Artikulli i tij rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, EULEX-i Kosovë, është botuar në Revistën vjetore të Forcave të Mbrotjtjes së Irlandës në vitin 2015.

**Znj. Joanna Marszalik**, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Drejtësi në nivelin master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar juriste në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit për Këshillin e institutit të Evropës në projektin ndërtues institucional "Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë" dhe udhëheqëse ekipi e këshillit të Evropës dhe projektit të Bashkimit Evropian "Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Juridik në Ukrainë", e cila ka mbështetur reformat e sistemit juridik të Ukrainës. Ajo iu bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku ka punuar si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit në prill të vitit 2012.

**Z. Paul Landers**, shtetas i Irlandës, është avokat, ku ka diplomuar në Honourable Society of King's Inns, Irlandë. Ai ishte ftuar në Odën e Avokatëve të Republikës së Irlandës. Ai gjithashtu ka diplomë pasuniversitare në të drejtat e njeriut dhe drejtësi penale në Universitetin Queen's University në Belfast, Irlandë e Veriut. Ai është ish-anëtar i Garda Síochána (Policia irlandeze) ku ka shërbyer për 15 vjet në Njësinë Speciale Detektive. Më pas, ai mori postin e këshilltarit ligjor dhe të drejta të njeriut në Garda Síochána. Z. Landers më parë ka punuar si zyrtar ligjor në Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të EULEX-it. Para se ta merrte detyrën e tij të tashme, ai ishte i punësuar në Misionin për sundimin e ligjit në gadishullin verilindor të Afrikës, si shef i Policisë me përgjegjësi në Xhibut, Somali, Somaliland, Puntland, Sishell dhe Tanzani. Ai është emëruar zyrtar ligjor i Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së në gusht 2015.

**Znj. Shpresa Gosalci**, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në master për marketing biznesi dhe menaxhment, në Universitetin AAB, Prishtinë. Ajo ishte punësuar si interprete (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri në mars të vitit 2009. Ajo është asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku i vitit 2010.

**Znj. Katica Kovacevic**, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit

nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo filloj punën si interprete/përkthyesë në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

**Z. Kushtrim Xhaferi**, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si interpret/përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të vitit 2009, e më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si interpret/përkthyes në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010.


## 4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

### 4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat


Në vitin 2015, Paneli ka shqyrtuar 38 lëndë. Paneli ka komunikuar një lëndë tek shefi i Misionit në bazë të rregullores së punës së tij, me kërkesë që të ofrohen vërejtje rreth pranueshmërisë dhe bazueshmërisë së asaj lënde.

Paneli ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut në katër raste dhe ka shpallur se nuk ka pasur shkelje në dhjetë të tjera. Paneli gjithashtu ka shpallur tetë lëndë të pranueshme. Përcaktimi i bazueshmërisë së këtyre lëndëve është në pritje. Në dy lëndë ku janë gjetur shkelje më parë, Paneli ka dhënë vendime pasuese.

Përveç kësaj, 12 lëndë janë shpallur të papranueshme dhe një lëndë është hequr nga lista e lëndëve për shqyrtim.



Në Panel në vitin 2015 janë regjistruar 16 lëndë të reja. Që nga fillimi në vitin 2010, në Panel janë parashtruar gjithsej 152 lëndë, ku 118 janë mbyllur me vendime përfundimtare.



## 4.2. Trendët

Shumica e shkeljeve të supozuara thuhet se janë rezultat i dështimit të supozuar të EULEX-it për të vepruar, e jo veprimet e tij pozitive. Ankesat e tilla kanë të bëjnë posaçërisht me refuzimin e supozuar të prokurorisë për të filluar hetimet dhe/ose dështimin për të ngritur padi në mënyrë efektive. Një numër lëndësh kanë të bëjnë me akuzat për procedura të padrejta dhe të tej zgjatura pranë gjykatave të Kosovës.

## 4.3. Subjekti i ankesave

Llojet më të shpeshta të shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut të shqyrtuara nga Paneli gjatë vitit 2015 ishin si në vijim:

- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për jetë (Neni 2 i Konventës; Neni 6 i Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike): lëndët e [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;
- Shkeljet e pretenduara të ndalimit të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës (neni 3 i Konventës; neni 7 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 6 paragrafët 1 dhe 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose poshtëruese): lëndët [Stanisic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 to 2013-14; të [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34; [Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it](#), nr. 2014-41;
- Shkeljet e pretenduara të së drejtës për liri dhe siguri (neni 5, paragrafi 1c, 2, 3 dhe 4 të Konventës, neni 9, par. 2 deri në 4 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike): lëndët [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri te T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Krasniqi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-33;
- Shkeljet e pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë (neni 6 i Konventës; neni 14 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike): lëndët [X dhe 115 të tjerë ankues kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunovic kundër EULEX-it](#) nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05; [Maksutaj kundër EULEX-it](#) nr. 2014-18; [J.Q. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-24; [Kaçiu kundër EULEX-it](#) nr. 2014-26; [Shabani kundër EULEX-it](#) nr. 2014-30; [K.P. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-31; [Mikic kundër EULEX-it](#) nr. 2014-38; [Hajdari kundër EULEX-it](#) nr. 2014-40;
- Shkeljet e pretenduara të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i Konventës; neni 17 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike): lëndët [Stanisic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Sula kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34;
- Shkeljet e pretenduara të së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 i Konventës; neni 18 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike): lëndët [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14;
- Shkelje e pretenduar e të drejtës për mjet efektiv (neni 13 i Konventës) në lidhje me

- Neni 6: [X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it](#), nr. 2011-20; [Radunovic kundër EULEX-it](#), nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05
- Neni 8: [Stanisic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11-2014-17; [L.O. kundër EULEX-it](#) nr. 2014-32; [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#) nr. 2014-34;
- Shkelje e pretenduar e së drejtës për trajtim të barabartë (neni 14 i Konventës; neni 26 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike): [Stanisic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14; [Radunovic kundër EULEX-it](#) nr. 2014-02; [Ibrahimi kundër EULEX-it](#) nr. 2014-05;
- Shkelje e pretenduar e së drejtës për gëzim paqësor të pronës (neni 1 i protokollit 1 të Konventës): [Begolli kundër EULEX-it](#) nr. 2014-27; [Musa kundër EULEX-it](#), nr. 2014-29; [Zherka kundër EULEX-it](#) nr. 2014-42.

Një numër i ankuesve ju kanë drejtuar në mënyrë të përgjithësuar disa instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut apo Konventës Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

## 5. Jurisprudenca

### 5.1. Meritat

#### 5.1.1. [X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it](#)

Më 22 prill 2015, Paneli ka vendosur që EULEX-i Kosovë kishte shkelur nenin 13 të Konventës, d.m.th. të drejtën për mjet efektiv në lëndën nr. 2011-20, [X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it](#). Për më tepër Paneli ka gjetur se nuk ishte e nevojshme që kjo lëndë të shqyrtohet në bazë të nenit 6 të Konventës (e drejta për gjykim të drejtë).

Lënda ishte parashtruar nga 116 persona të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), të përkatësisë etnike rome që ishin zhvendosur gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe ri-vendosur në një numër kampesh të administruara të PZHBV-së të UNMIK-ut. Ankuesit kanë pretenduar se një numër i të drejtave të njeriut të tyre ishin shkelur gjatë ose si pasojë e qëndrimit të tyre në ato kampe. Në veçanti, ata pohuan se iu ishin ekspozuar rreziqeve të rënda shëndetësore në këto kampe. Më parë, ata kishin parashtruar një ankesë në lidhje me kushtet e jetesës dhe probleme shëndetësore në ato kampe pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNJ). Lënda që fillimisht ishte shpallet e papranueshme është rihapur dhe aktualisht është e pazgjidhur pranë PKDNJ-së.

Në vendimin e tij mbi pranueshmërinë e lëndës (të marrë me 5 tetor 2012), Paneli ka konstatuar se ankesa është e papranueshme në lidhje me akuzat për keqtrajtim dhe kushte të papërshtatshme të jetesës në kampet e PZHBV-së. Ankuesit parashtruan se EULEX-i kishte njohuri rreth kushteve të rrezikshme të jetesës, por nuk kishte arritur të ndërmerre ndonjë veprim për t'i zhvendosur romët nga kampet apo për t'ju ofruar atyre trajtim mjekësor. Paneli ka konstatuar se EULEX-i asnjëherë nuk ka qenë përgjegjës i kampeve të PZHBV-së në Kosovë, pasi UNMIK-u e kishte dorëzuar përgjegjësinë për kampet e mbetura autoriteteve të Kosovës në vitin 2008. Megjithatë, pa

paragjykuar meritat e ankesës, Paneli ka shpallur ankesën të pranueshme sa i përket dështimit të supozuat nga EULEX-i për të siguruar që ankuesit të kishin qasje në drejtësi, me qëllim që të kërkonin një zgjidhje efektive për shkeljen e pretenduar të të drejtave të tyre.

Në vendimin e tij të mëvonshëm të datës 22 prill 2015 mbi meritat e lëndës, Paneli ka konsideruar se dështimi i EULEX-it që të nisë një hetim efektiv dhe me kohë për shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesve ka dëmtuar aftësinë e tyre për të pasur zgjidhje efektive. Paneli ka konstatuar se në bazë të nenit 1. (1) të Ligjit nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, misioni ka ruajtur juridiksionin në lidhje me rastet “që janë në vazhdim e sipër” brenda kuptimit të kësaj dispozite. Një rast konsiderohet se është në vazhdim e sipër nëse një vendim për fillimin e hetimeve ishte paraqitur nga prokurorët e EULEX-it para 15 prillit 2014. Sipas atij ligji, data në të cilën viktimat e kanë bërë raportimin tek autoritetet kompetente ishte jorelevante për të përcaktuar në bazë të këtij ligji nëse një rast është në vazhdim apo jo. Pala nuk ka pasur kontroll apo ndikim kur duhej të merrej vendimi për fillimin e hetimit. Pra, pavarësisht nga fakti se ankuesit në këtë çështje kanë sjellë lëndën e tyre në vëmendjen e autoriteteve në nëntor të vitit 2013, ata nuk kanë mundur të ushtronin ndikim që lënda e tyre të konsiderohej “në proces e sipër” dhe si e tillë të mbahej nga EULEX-i. Paneli theksoj më tej se nëse do të ishte marrë vendimi i prokurorit për të nisur hetimin (i marrë me 15 prill 2014) vetëm një ditë më parë, lënda do të kishte hyrë në kuadër të nocionit të lëndëve “në proces e sipër”. Për këtë arsye, autoritetet e EULEX-it do të kishin mbajtur juridiksionin për të kryer hetimin e lëndës. EULEX-i nuk ka arritur të ofroj ndonjë shpjegim të besueshëm lidhur me vendimin e vet për të mos vepruar në afatin e fundit dhe nuk ka dhënë ndonjë arsye që do ta kishte penguar atë për të vepruar ashtu.

Po ashtu Paneli ka konstatuar se në bazë të nenit 7 (A) i ligjit nr. 04/L-273 ishte e mundur që prokuroria e EULEX-it të merrte përsipër lëndët nëse ishte e arsyetuar prej “rrethanave të jashtëzakonshme”. Sipas pikëpamjes së Panelit, EULEX-i ka dështuar të shpjegoj se pse në bazë të të gjitha rrethanave relevante prokurorët e EULEX-it nuk e ka bërë këtë, veçanërisht pasi rasti nuk ishte hetuar siç duhej deri në atë fazë dhe dështimi për të vepruar me gjasë do të çonte në privimin e viktimave në qasjen në mjete efektive. Paneli ka theksuar se rasti në fjalë ndër të tjera kishte të bëjë me një ndër të drejtat themelore të njeriut, e drejta për jetën. Kjo kishte bërë që të zhvilloheshin një numër procedurash, ku banorët e kampeve kanë kërkuar ndihmë dhe kompensim nga organet dhe organizatat e ndryshme, të gjitha pa ndonjë dobi. Ka pasur edhe një element etnik të qartë të qenësishëm në lëndën ku banorët ishin romë. Të gjitha këto rrethana ishin të domosdoshme për të shqyrtuar nëse rrethanat e jashtëzakonshme në kuptimin e nenit 7 (A) kishin ndodhur dhe nëse çështja nuk duhej të ishte mbajtur nga prokuroria e EULEX-it. Edhe pse autoritetet e prokurorisë së EULEX-it kanë një kompetencë të pakufizuar për të marrë përsipër rastet ku ata e konsiderojnë të jashtëzakonshme, diskrecioni nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare. Ajo duhet të ushtrohet me zell në dritën e të gjitha rrethanave përkatëse dhe në një mënyrë që është në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, të cilat sipas mendimit të Panelit, nuk ishte demonstruar në rastin në fjalë.

Paneli ka konstatuar se vendimi i Misionit që mos të nis ndonjë hetim deri pas datës së fundit të 14 prillit 2014 ka ndikuar negativisht në aftësinë e ankuesve për të kërkuar dhe marrë ndonjë ndihmë efektive ligjore për dëmin e bërë ndaj tyre. Edhe pse mungesa e një hetimi penal apo e një vendimi përfundimtar në një lëndë penale e bën të pamundur me ligj që të kërkoet përgjegjësi civile para gjykatave civile kundër personave në lidhje me të cilët gjykatat civile të Kosovës kanë juridiksion, kjo e ka dëmtuar në mënyrë serioze aftësinë e ankuesve për të kërkuar kompensim përmes përgjegjësisë civile.



Paneli gjithashtu ka bërë rekomandime shefit të Misionit për masa korrigjuese. Paneli ka rekomanduar që ShM-ja duhet të udhëzoj zyrtarët kompetent të EULEX-it që të hetojnë me autoritetet e Kosovës nëse një hetim mbi shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesve ishte duke vazhduar. Më tej, është rekomanduar që ShM-ja duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it të marrin në konsideratë nëse do të marrin përsipër përgjegjësinë e këtij rasti, duke marrë parasysh në veçanti nevojën që Misioni të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesve.

#### Vendimi pasues lidhur me rekomandimet e Panelit

Në vendimin e tij pasues të datës 11 nëntor 2015, Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit kishte zbatuar rekomandimet e tij vetëm pjesërisht. Paneli ka pranuar se shefi i Misionit ka zbatuar rekomandimin e Panelit për të kërkuar nga autoritetet vendore nëse hetimi lidhur me rastin ishte në vazhdim e sipër. Megjithatë nuk i ishte treguar Panelit se kishte pasur përparim të vërtetë në hetim. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se kryeprokurori i shtetit të Kosovës dhe prokurori i EULEX-it kanë vendosur mos t'ia caktojnë rastin ndonjë prokurori të EULEX-it. Paneli ka konsideruar se hapat e marra nga Misioni ishin të pamjaftueshme dhe se e drejta e ankuesve për mjete efektive ka vazhduar të ndikohet negativisht në mungesë të një hetimi efektiv. Paneli ka deklaruar se do të vazhdoj shqyrtimin e këtij rasti në kuadër të procedurës pasuese dhe ka ftuar ShM-në që ta njoftoj atë lidhur me progresin e hetimit deri me datën 28 shkurt 2016.

#### 5.1.2. Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it

Në këtë rast, Paneli ka shqyrtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut në lidhje me nenin 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtërujes), nenin (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), nenin 13 (e drejta për një zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

Ankesat kishin të bënin me hetimet e caktuara në veprat penale që supozohet se ishin kryer ndaj ankuesve. Në të gjitha rastet, prokurorët e EULEX-it në krye të hetimeve kanë hedhur poshtë kallëzimet penale të paraqitura nga ankuesit me arsyetimin se nuk kishte pasur "asnjë dyshim të arsyeshëm që personi konkret e kishte kryer veprën e tillë penale". Ankuesit kanë marrë përmes postës elektronike njoftime formale rreth hedhjes poshtë të ankesave të tyre dhe janë informuar për të drejtën e tyre për të ndjekur më tej rastin si "paditës privat".

Në lidhje me shkeljet e pohuara të nenit 3 të Konventës, Paneli nuk është bindur se ankuesit kanë treguar se me anë të veprimeve ose mosveprimit të tij EULEX-i i ka trajtuar ata me ndonjë trajtim të atillë që do të hynte në kuadër të kësaj dispozite dhe ka gjetur se ankesa haptazi është e pabazuar.

Duke i shqyrtuar shkeljet e pretenduara të nenit 8 të Konventës, Paneli ka përsëritur se nocioni i "jetës private" është një nocion i gjerë dhe nuk i nënshtrohet përkufizimit gjithëpërfshirës; mundet që në varësi të rrethanave të përfshijë integritetin moral dhe fizik të personit, të mbrojtjen shtëpinë e personit dhe disa aktivitete apo lokalet profesionale ose afariste. Dështimi i autoriteteve për të mbrojtur integritetin fizik ose moral të personit ose për të parandaluar sulmet në shtëpinë dhe pronën e tyre mund të ngjitë çështjet sipas nenit 8 të Konventës në kuadër të detyrimeve të tyre pozitive. Megjithatë, Paneli vuri në dukje se, derisa të drejtat në nenin 8 të ankuesit mund të jenë shkelur nga palët e treta, nuk ishte treguar se si veprimet ose mosveprimi nga EULEX-i do të kishte qenë pjesë e një shkeljeje të tillë. Paneli ka konkluduar se faktet e rastit nuk zbulojnë ndonjë shkelje të nenit 8 të Konventës nga ana e EULEX-it.

Pastaj Paneli ka shqyrtuar shkeljet e pohuara të nenit 13 të Konventës. Paneli ka theksuar se ekzistenca e një shkeljeje aktuale të një dispozite materiale të Konventës nuk është parakusht për

zbatimin e këtij neni, me kusht që ankesat e tyre sipas këtyre dispozitave mund të konsiderohet si e “diskutueshme”. Zgjidhja efektive që kërkohet nga neni 13 duhet të jetë “efektiv” në praktikë ashtu edhe në ligj. Neni 13 jo gjithmonë mund të kërkoj që autoritetet të ndërmarrin hetimin rreth një dështimi të pretenduar nga ana e autoriteteve për të mbrojtur personat nga veprimet e të tjerëve. Megjithatë kur ekziston një zgjidhje efektive e tillë, ajo duhet të jetë efektive, pra e aftë që të ofruar korrigjim dhe mundësi të arsyeshme për sukses.

Paneli ka theksuar se EULEX-i ka kryer një hetim rreth secilit pretendim të parashtruar nga ankuesit dhe në mënyrë të rregullt ka marrë veprime të ndryshme. Në atë masë, Paneli ka konkluduar se Misioni nuk mund të thuhet se ka neglizhuar që të hetoj tërësisht një aspekt të veçantë të rastit. Për më tepër, Paneli nuk kishte gjetur ndonjë tregues se ankuesit ishin diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Megjithatë Paneli ishte i shqetësuar lidhur me të metat në procesin hetimor: mungesa e dukshme e përfshirjes së ankuesve aty dhe mungesa e një shpjegimi të arsyetuar për ndërprerjen e procedurës në këto raste. Paneli ka përsëritur se viktimat në parim kishin të drejtë të jenë të përfshira mjaftueshëm në hetim dhe kishin të drejtë të jenë të informuar rreth hetimit, duke iu nënshtruar konfidencialitetit dhe sigurisë. Edhe përfshirja e viktimave në procesin hetimor dhe nevoja për një shpjegim të arsyetuar të ndërprerjes kishin qëllim të krijonte një shkallë të mjaftueshme të hetimit publik dhe llogaridhënie dhe një ndjenjë në mesin e viktimave që ata janë trajtuar në mënyrë të drejtë dhe se kërkimi i tyre i drejtësisë është ndjekur me kujdes dhe në mënyrë efektive. Për më tepër, mungesa e shpjegimit të arsyeshëm ose arsyeve jo të përshtatshme të dhëna për përfundimin ose ndërprerjen e hetimeve mund që të mos jetë në përputhje me mbrojtjen e të drejtave, në veçanti të së drejtës së viktimës drejt një mjeti efektiv. Rrjedhimisht, Paneli ka konkluduar se në rrethanat e rastit ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesve të garantuara me nenin 13 të Konventës. Më tej Paneli ka konsideruar se nuk ishte e nevojshme për të shqyrtuar ankesën sipas nenit 14 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

Paneli ka bërë një rekomandim që të zbatohen masat korrigjuese nga shefi i Misionit për ta trajtuar shkeljen.

#### 5.1.3. [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri në T\) kundër EULEX-it](#)

Paneli ka shqyrtuar rastet e paraqitura nga dhjetë ankuesit e përkatësisë etnike serbe, të cilët ishin arrestuar dhe supozohej se ishin rrahur nga zyrtarë policor të Kosovës, përderisa ishin të pranishëm në festimet e krishtlindjeve në manastirin e Graçanicës në vitin 2013. Ankuesit pohuan se EULEX-i kishte dështuar t'i mbroj ata nga arrestimi arbitrar dhe nga keqtrajtimi prej Policisë së Kosovës dhe kështu duke shkelur nenin 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtërujes), nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri), nenin 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të KEDNj-së.

Paneli së pari ka përsëritur gjetjet e bëra në “rastet e Vidovdanit”<sup>2</sup> që fakti se operacionet e policisë në atë ditë ishin udhëhequr nga policia e Kosovës dhe kishin hyrë në kuadër të përgjegjësisë parësore të Policisë së Kosovës nuk e përjashton përgjegjësinë e EULEX-it lidhur me veprimet apo dështimet e veta për aq sa ato kishin të bënin me ushtrimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Në rrethanat të tilla, Paneli do të shqyrtoj nëse ndonjë e metë që i atribuohet EULEX-it, duke përfshirë dështimin e tij për të vepruar, mund të ketë bërë shkelje apo mund të ketë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesve.

---

<sup>2</sup> A,B,C,D kundër EULEX-it, 2012-09 deri 2012-12, 10 prill 2013

Duke pasur parasysh pranueshmërinë e ankesës sipas nenit 5 të Konventës, Paneli ka gjetur se nuk ishte vërtetuar se ndalimi i ankuesve ishte i paligjshëm dhe i pajustificuar. Rrjedhimisht, Paneli ka konstatuar se ankesa ishte qartas e pabazuar.

Pastaj Paneli ka shqyrtuar ankesën sipas nenit 3. Paneli ka konstatuar se policët e EULEX-it, të përfshirë në ato ngjarje ishin duke vepruar në një kapacitet këshillues dhe ishin duke ushtruar përgjegjësitë e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK-së). Megjithatë ekziston një detyrim pozitiv sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit për zyrtarët e EULEX-it që të veprojnë kur ata përballen me një kërcënim të ndonjë shkeljeje të afërt dhe të rëndë të të drejtave individuale. Një detyrim i tillë nuk preket nga kapaciteti në të cilin policët e EULEX-it veprojnë së bashku, ose në bashkëpunim me autoritetet e Kosovës. Natyra e përgjigjes duhet që në të gjitha rastet të jetë e përshtatshme për rrethanat dhe nga ana tjetër të varet se çfarë të drejta kanë qenë në rrezik dhe të varet në seriozitetin e kërcënimeve që iu paraqitet këtyre të drejtave. Një detyrim i tillë duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk imponon një barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet.

Paneli ka konstatuar se policët e EULEX-it nuk ishin të pranishëm gjatë incidenteve dhe se kishin mësuar rreth tyre më vonë. Ata nuk ishte dëshmitar në momentin e arrestimit të ankuesve, por më vonë kishin intervistuar ankuesit, të cilët në kohën e vizitës së EULEX-it në qendrën e paraburgimit, dukej se ishin në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk ankoheshin për ndonjë keqtrajtim. Paneli ka konkluduar se ankuesit nuk kishin treguar në asnjë moment ku mund të thuhet se zyrtarët e EULEX-it kishin ditur ose duhej të ishin në dijeni se mirëqenia e tyre ishte në rrezik. Për më tepër, përkundër “rasteve të Vidovdanit”, këtu nuk ishte treguar se mjetet e caktuara nga EULEX-i ishin të pamjaftueshme për të monitoruar ngjarjet e ditës së krishtlindjeve që kishin kontribuar në shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesve.

Paneli ka konkluduar se policia e EULEX-it bëri gjithçka që kishte mundësi të pritej prej tyre në ato rrethana. Për më tepër, janë ndërmarrë hapa hetues për të adresuar shkeljet e supozuara të cekura në ankesa; kishte nisur një hetim i përbashkët nga PK-ja dhe EULEX-it nën mbikëqyrjen e një prokurori të EULEX-it dhe autorët e dyshuar në fund ishin akuzuar. Prandaj, situata për të cilën ka pasur ankesë nuk ka përbërë shkelje të nenit 3 të Konventës që i atribuohet EULEX-it.

Duke pasur parasysh gjetjet në bazë të nenit 3, Paneli ka konsideruar të panevojshme që ta shqyrtoj ankesën ndaras sipas nenit 9 dhe nenit 14 të Konventës.

#### 5.1.4. *Fitim Maksutaj kundër EULEX-it*

Më 12 nëntor 2015, Paneli ka gjetur se EULEX-i Kosovë ka shkelur nenin 6(1) të Konventës, pra të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, në rastin nr. 2014-18, *Maksutaj kundër EULEX-it*.

Ankuesi ka pohuar se hetimet penale ndaj tij kishte filluar me 11 tetor 2006 dhe nuk ishin përfunduar gjatë kohës kur ankesa e tij ishte parashtruar në Panel (19 mars 2014). Ai ka pretenduar se si rezultat i këtij hetimi që është në vazhdim e sipër ai ishte suspenduar nga punëdhënësi i tij dhe nuk kishte qenë në gjendje të punësohej gjatë asaj kohe. Paneli ka konstatuar se procedurat e kryera nga prokurori i EULEX-it nuk ishin kryer me kujdesin dhe shpejtësinë e nevojshme.

Paneli ka adresuar çështjen e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes që ka marrë për të shqyrtuar këtë rast dhe ka kufizuar shqyrtimin e tij në periudhën kur EULEX-i ka qenë përgjegjës për hetimin e rastit (nga janari 2009 deri në dhjetor 2014). Hetimi fillestar kishte filluar nga UNMIK-u me 11 tetor 2006 dhe ishte bartur EULEX-it në janar 2009. Megjithatë, Paneli ka konkluduar se kohëzgjatja e

përgjithshme e procesit ndaj ankuesit dhe në veçanti shkalla e përparimit të hetimit kur EULEX-i kishte marrë përsipër atë, ishte e rëndësishme në vlerësimin e urgjencës me të cilën Misioni ka vepruar në zgjidhjen e kësaj lënde.

Në adresimin e çështjes së arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, Paneli ka shqyrtuar rrethanat e veçanta të rastit dhe ka konsideruar një numër faktorësh të veçantë të rëndësishme, pra kompleksitetin e lëndës, sjelljen e aplikantit dhe sjelljen e administratës kompetente. Paneli ka identifikuar një periudhë të tej zgjatur midis marsit 2010 dhe marsit 2013, në të cilën nuk ka pasur përpjekje të dukshme nga ana e prokurorit të EULEX-it për të përparuar dhe për të përfunduar lëndën. Përveç kësaj, Paneli ka shqyrtuar të meta të caktuara nga prokurori gjatë lëndës. Paneli ka konkluduar se këto të meta në hetim kanë pasur një ndikim negativ në kohëzgjatjen e përgjithshme dhe kanë kontribuar në mohimin e së drejtës së ankuesit për një zgjidhje të shpejtë të lëndës ndaj tij.

Paneli gjithashtu ka shqyrtuar pasojat e këtyre të metave për të akuzuarin dhe ka zbatuar qasjen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet kur nga autoritetet kërkohet që të veprojnë me shpejtësi të veçantë për zgjidhjen e lëndëve, bazuar në ndikimin negativ ndaj ankuesit, duke përfshirë mundësitë për punësim. Në veçanti, Paneli ka vënë në dukje se "... pavarësisht që prokurori i EULEX-it ishte njoftuar rreth vështirësisë së ankuesit në lidhje me atë se ai ishte i papunë, asnjë përgjigje nuk i ishte dhënë ankuesit për kërkesën e tij për sqarim dhe zgjidhje të çështjes".

Paneli ka konkluduar se duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të këtij rasti, Paneli është i mendimit se procedurat (të cilat kanë zgjatur nga janari 2009 deri më 15 dhjetor 2014) "nuk ishin kryer me një shkallë të duhur kujdesi dhe shpejtësisë". Paneli ka gjetur se "lënda ishte lënë e paprekur për një periudhë të gjatë kohore dhe ankuesi kishte mbetur me paqartësi lidhur me statusin e lëndës së tij përkundër kërkesave të përsëritura për sqarim. Këto vonesa të paarsyeshme kanë rezultuar në shkeljen e të drejtës së ankuesit për një proces të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 6 (1) të Konventës".

Paneli ka bërë rekomandime që të zbatohen masat korrigjuese nga shefi i Misionit për të trajtuar shkeljen, duke përfshirë ndërmarrën e të gjitha masave të nevojshme për të kryer një hetim lidhur me atë se çfarë hapash mund të ndërmerren nga zyra e kryeprokurorit të EULEX-it (ZKPE) për të siguruar që lëndët nën autoritetin e kësaj zyre trajtohen në përputhje me dispozitat e nenit 6(1) të Konventës dhe që ekziston një mekanizëm efektiv shqyrtues për të siguruar që të gjitha rastet e tilla trajtohen brenda një afati të arsyeshëm.

#### 5.1.5. L.O. kundër EULEX-it

Lënda *L.O kundër EULEX-it* (nr. 2014-32) ishte parashtruar nga gruaja e një personi të zhdukur që nga viti 1999. Zhdukja e tij fillimisht ishte hetuar nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK-ja). Prokurorët e EULEX-it kanë vazhduar hetimet dhe më pas ajo ishte marrë përsipër nga Task Forca Hetimore Speciale (TFHS). Ankuesja ka pohuar se EULEX-i ka dështuar të kryej një hetim efektiv për zhdukjen e bashkëshortit të saj, duke shkelur nenin 2 të Konventës, i cili parasheh obligimin për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta. Fati i tij i paditur i ka shkaktuar ankueses vuajtje emocionale.

Paneli ka deklaruar se EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankueses sipas nenit 2 (obligimi për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta), nenit 3 (sa i përket vuajtjes rreth fatit të paditur të të afërmeve që ju

shkaktohen ankuesve), nenit 8 (të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 13 (e drejta për një mjet efektiv) të Konventës.

Paneli ka përsëritur se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet me atë që mund të pritët nga një shtet. Ai gjithashtu ka pranuar vështirësitë e përfshira në hetimin e krimeve në një shoqëri që ndodhet pas konfliktit siç është Kosova, por u shpreh se këto vështirësi nuk duhet të justifikojë të gjitha mangësitë hetimore. Në çdo rast, autoritetet hetimore pritët të veprojnë me kujdes të arsyeshëm dhe shpejtësi dhe të përdorin burimet e nevojshme për të zgjidhur çështjen. Paneli ka theksuar se hetimi i fatit të të zhdururve duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in, si mision për sundimin e ligjit. Paneli ka konstatuar se nuk kishte juridiksion *ratione temporis* mbi këtë rast, pasi ka ekzistuar një "lidhje e vërtetë" ndërmjet shkeljeve të pretenduara të të drejtave të ankuesit dhe juridiksionit të Panelit.

Paneli ka shqyrtuar ankesën në lidhje me dy faza të veçanta: përpara dhe pasi që TFHS-ja e kishte informuar Misionin që do ta hetonte këtë lëndën.

Për sa i përket periudhës së parë, Paneli ka theksuar se parashtresat ShM-së nuk përfshinin informata të mjaftueshme për Panelin për të qenë në gjendje që të verifikoj natyrën dhe shtrirjen e përpjekjeve hetimore të EULEX-it. Prandaj Paneli duhej nxjerrë përfundime të nevojshme nga mungesa e një informacioni të tillë, sidomos duke pasur parasysh seriozitetin e shkeljes së pretenduar. Nuk kishte asnjë tregues se deklaratat e dëshmitarëve ishin marrë nga prokurorët e EULEX-it, se ndonjë hetim i besueshëm i mjekësisë ligjore ishte kryer nga Misioni apo cilat qasje hetimore ishin ndjekur në këtë rast. Siç duket kishte vetëm një kontakt të drejtpërdrejtë verbal mes ankuesit dhe Misionit. Sipas mendimit të Panelit, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të garantuar mbrojtjen procedurale të garantuar me nenin 2 dhe 3 të Konventës, kështu ka prekur negativisht gëzimin e ankueses në të drejtën e saj sipas nenit 8 dhe 13.

Për më tepër, Paneli vëren se reagimi i Misionit ndaj përpjekjeve të ankueses për të gjetur se çfarë progresi ishte duke u bërë në hetim ishte i pamjaftueshëm; ajo ka marrë vetëm minimumin e informacionit dhe vetëm atëherë kur ajo bënte presion për përgjigje. Paneli theksoj rëndësinë që autoritetet hetimore duhet të kenë në mënyrën me të cilën komunikojnë me viktimat e shkeljes së të drejtave apo të afërmeve të tyre.

Në fund Paneli ka konstatuar se kompetenca dhe përgjegjësia e EULEX-it për të hetuar krimet që bien në kuadër të mandatit të tij nuk është e kushtëzuar nga veprimet e palës së dëmtuar. Në një rast të tillë si ky, EULEX-i ishte përgjegjës për të vepruar *proprio motu*, me qëllim që të sigurohej se rasti i zhdurjes ishte duke u hetuar me kujdes, menjëherë dhe në mënyrë efektive.

Mbi këtë bazë, Paneli ka konstatuar se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe jo të duhura për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3 (pjesët procedurale), 8 dhe 13.

Pas kësaj Paneli ka konsideruar gjendjen pasi TFHS-ja kishte njoftuar Misionin se po e hetonte atë lëndë. Paneli ka kritikuar mungesën e transparencës dhe qartësisë që prek bazën ligjore në bazë të së cilës vepron TFHS-ja dhe statusi i saj brenda EULEX-it Kosovë. Paneli ka konstatuar se mungesa e qartësisë dhe transparencës e ka bërë pothuajse të pamundur shqyrtimin e aktiviteteve të saj nga ana e Panelit. Paneli ishte i mendimit se përderisa përfshirja e TFHS-së mundet ta ndihmojë ankuesen drejt kërkimit të drejtësisë, deri më tani ajo nuk ka kontribuar dukshëm në sigurimin e mbrojtjes efektive për të drejtat e saja. Pa pasur informata më të qarta dhe më të hollësishme rreth veprimeve dhe kontributit të TFHS-së për të hetuar këtë rast, Paneli nuk kishte alternative përveç

se të nxjerrë përfundimin e nevojshme se të drejtat e ankueses kanë qenë dhe vazhdojnë të shkelen.

Paneli ka konstatuar se viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të afërmit e tyre si dhe publiku në parim kanë të drejtë që të jenë të informuar mjaftueshëm lidhur me përparimin e një hetimi. Paneli ka pranuar argumentin e ShM-së se për të mbrojtur integritetin e përpjekjeve të vazhdueshme hetimore ka pasur nevojë që të garantohej një nivel i mjaftueshëm i konfidencialitetit, veçanërisht në ato raste ku mbrojtja e dëshmitarëve dhe informatorëve ishte kryesore. Sidoqoftë Paneli ishte i mendimit se Misioni nuk kishte arritur t'i siguroj informacion të mjaftueshëm ankueses lidhur me këtë hetim dhe në një mënyrë dhe me një afat kohor të nevojshëm dhe të përshtatshme për lëndën. Nuk janë dhënë arsye se pse të afërmit nuk kishin mundur që rregullisht të informoheshin, në mënyrë të përgjithshme se çfarë përpjekjesh ishin duke u bërë dhe se deri ku kishte përparuar çështja.

Paneli ka bërë disa rekomandime që të zbatohen disa masa korrigjuese nga shefi i Misionit për t'i adresuar shkeljet.

## 5.2. Pranueshmëria

Në disa vendime, Paneli ka adresuar çështje të ndryshme të rëndësishme lidhur me pranueshmërinë e ankesave të parashtruara aty:

### 5.2.1. Lëndët e personave të vrarë dhe të zhdukur

Në vitin 2015, Paneli ka shqyrtuar tetë lëndë lidhur me fatin e personave që ishin vrarë apo zhdukur që prej vitit 1999 dhe 2000 ([D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17 dhe lëndën [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34). Ankesat ishin parashtruar nga familjarët e të zhdukurve, të cilët kanë pohuar se EULEX-i kishte dështuar të kryente hetime rreth vdekjes dhe zhdukjeve të të afërme të tyre.

Duke pasur parasysh pranueshmërinë e ankesave, Paneli ka refuzuar parashtresat e shefit të Misionit se Panelit i mungonte juridiksioni *ratione materiae* mbi disa nga lëndët mbi bazën se këto lëndë asnjëherë nuk kishte qenë në kompetencë të prokurorëve të EULEX-it dhe se asnjë veprim ose mosveprim që ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit mund t'i ngarkohet Misionit. Paneli ka konstatuar se ka pasur bazë të mjaftueshme ligjore duke marrë parasysh kompetencat e prokurorëve të EULEX-it mbi lëndët që kërkonin një hetim të këtyre lëndëve.

Paneli ka vënë në dukje se Ligji mbi Kompetencat parasheh kompetencë të veçantë të prokurorëve të EULEX-it për të hetuar dhe ndjekur penalisht, ndër të tjera krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, si dhe kompetenca të përbashkëta për rastet të cilat nuk mund të konsiderohen krime lufte, por që do të hyjnë në kuadër të kapitujve të rregullta të Kodit Penal. Obligimi i Misionit për të hetuar këto lëndë ishte ngritur edhe nga nenet 2 dhe 3 të Konventës. Paneli ka refuzuar argumentin e shefit të Misionit se prokurorët e EULEX-it asnjëherë nuk kanë pasur kompetencë për të hetuar këto raste pasi shkresat e lëndës asnjëherë nuk kishin arritur zyrtarisht. Paneli ka konstatuar se ishte përgjegjësi e Misionit për të siguruar organizimin e të dhënave të veta dhe bartjen e tyre në një mënyrë të tillë që garanton mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Për më tepër, Misioni ishte informuar rregullisht nga ankuesit rreth ekzistencës së rasteve të tyre dhe kjo ishte përgjegjësia e Misionit për të zhvilluar hetime rreth tyre, atëherë kur ato u sollën në vëmendjen e tij.

Për sa i përket kompetencave të tij *ratione temporis*, Paneli ka theksuar se ankesat nuk kanë të bëjnë me vrasjet aktuale të të afërmeve të ankuesve, por rretyh dështimit të supozuar që të hetohen rastet e tyre, pra pjesët procedurale, kundrejt pjesëve substanciale të neneve 2 dhe 3. Për më tepër, ankuesit asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga ndjekja e pretendimit të tyre nga autoritete të ndryshme (duke përfshirë UNMIK-un dhe degë të ndryshme të EULEX-it), të cilat ata mendonin se mund t'ju ndihmojnë që të marrin informacionin e duhur. Edhe pse nuk kishte ndonjë hetim që ishte duek u zhvilluar në atë moment dhe se kompetencat e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar mund të ishin të kufizuara në bazë të ligjit të ndryshuar për Kompetencat, EULEX-i ka qenë i përfshirë në hetimet e këtyre çështjeve. Prandaj Misioni kishte obligim për të siguruar që ato të zhvilloheshin me zell dhe me kohë.

Paneli gjithashtu ka gjetur se ankesat kanë hyrë në kuadër të juridiksionit të tij, pasi ato kishin të bënin me veprimet e prokurorëve të EULEX-it. Paneli tashmë në mënyrë të përsëritur ka konstatuar se kishte juridiksion për të shqyrtuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it, pasi ato përbënin thelbin e mandatit ekzekutiv të Misionit (për më shumë hollësi, shih pikën 5.2.3. më poshtë).

#### 5.2.2. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave të Kosovës

Në një numër vendimesh (p.sh. [Kaçiu kundër EULEX-it](#), nr. 2014-26; [Krasniqi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-33; [J.Q. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-24), Paneli ka përsëritur qëndrimin e tij se në bazë të Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk ka juridiksion sa i përket aspekteve administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës (shih 2.2 më lartë). Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

#### 5.2.3. Kompetenca e Panelit për të shqyrtuar veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it

Paneli ka përsëritur se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të ndërmarra brenda kontekstit të hetimit penal ishin pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe prandaj në parim kanë hyrë në kuadër të mandatit të Panelit. Veprimet apo mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk do të konsiderohen si pjesë përbërëse e "procedurave gjyqësore" për qëllimet e përcaktimit të kompetencës së Panelit. Prandaj veprimet e tyre mund të jetë subjekt i autoritetit rishikues të Panelit aty ku shkeljet e të drejtave të njeriut supozohet se kanë ndodhur (shih për shembull, lëndët [Stanisic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-22; [D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R. kundër EULEX-it](#), nr. 2014-11 deri 2014-17 dhe lënda [Sadiku-Syla kundër EULEX-it](#), nr. 2014-34).

I njëjti parim zbatohet për veprimet e policisë së EULEX-it. Fakti i thjeshtë se operacionet e policisë janë të udhëhequr dhe bien në përgjegjësinë kryesore të Policisë së Kosovës nuk e përjashton faktin se EULEX-i mund të mbahet përgjegjës për veprimet apo dështimet e veta në masën që ato ndikojnë në ushtrimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it (lëndët [K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#), nr. 2013-05 deri 2013-14)

Për më tepër, Paneli ka theksuar se nuk mund të përjashtohet se mund të jetë kompetent për të vlerësuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ato i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, nëse ato ngritin çështjet e të drejtave të njeriut dhe në qoftë se ato nuk janë adresuar plotësisht nga organet kompetente gjyqësore (lënda [K, L, M, N, O, P, Q, R, S dhe T \(K deri T\) kundër EULEX-it](#)).

### 5.3. Vendimet pasuese

Përveç vendimit në lëndën *X dhe 115 ankes të tjerë kundër EULEX-it* të diskutuara më lartë, Paneli ka marrë edhe një tjetër vendim pasues.

Në lëndën [\*Goran Becic kundër EULEX-it\*](#), Paneli ka shqyrtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut në lidhje me nenin 13 (e drejta për mjete efektive) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, si dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventa (e drejta për respektimin e pasurisë).

Ankuesi ka poseduar një banesë në Prishtinë dhe pavarësisht nga vendimi gjyqësor, ku vërtetohet pronësia e tij në atë banesë, ai nuk ka arritur të rimarrë në posedim atë. Ankuesi ka parashtruar padi penale në zyrën e prokurorisë publike komunale në Prishtinë ndaj disa uzurpuesve të paligjshëm. Ai gjithashtu ka informuar EULEX-in përmes postës elektronike rreth rastit të tij dhe më pas u informua se ankesa e tij i ishte dërguar disa njësive në kuadër të Misionit të EULEX-it. Megjithatë, ankesa e tij nuk ishte regjistruar nga EULEX-i. U deshën dy vjet e nëntë muaj pas kontaktit të parë të ankuesit me EULEX-in për prokurorët e EULEX-it që të njoftohen rreth këtij rasti.

Më 1 korrik 2014, Paneli ka shpallur ankesën të pranueshme dhe ka gjetur se ajo ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe të ligjit lidhur me shkeljet e pohuara të neneve 13, 14 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Më 12 nëntor 2014, Paneli ka marrë vendim mbi meritat e çështjes dhe ka gjetur se EULEX-i Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesit sa i përket mjetit efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës. Paneli ka konstatuar se duhej të pritej që pretendimet e argumentuara që janë sjellë në EULEX të regjistroheshin dhe shënoheshin siç duhej nga Misioni dhe se ato duhej t'i dorëzoheshin prokurorëve kompetent të EULEX-it në kohën e duhur. EULEX-i nuk ka arritur të funksionalizoj një sistem të besueshëm të shënimit dhe regjistrimit të ankesave që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave duke përfshirë shkeljet e supozuara të të drejtave ku ka rezultuar që lënda e ankuesit të mbetet pezull për një periudhë të tejzgjatur. Paneli i ka bërë rekomandime për masa korrigjuese shefit të Misionit. Paneli ka kërkuar nga ai që të siguroj që regjistrimet ekzistuese dhe procedurat fillestare të vlerësimit për ankesat që parashtrohen në EULEX, për aq sa ato kanë të bëjnë me ushtrimin e mandatit ekzekutiv të misionit, të vlerësohen nga stafi me ekspertizë ligjore dhe ekspertizë të të drejtave të njeriut dhe si pasojë t'i komunikohen njësive përkatëse.

Në [vendimin pasues](#) të datës 11 nëntor 2015, Paneli ka konkluduar se shefi i Misionit kishte zbatuar rekomandimet e tij dhe e ka mbyllur shqyrtimin e ankesës.

## 6. Aktivitetet e Panelit

### 6.1. Fushata informuese e vitit 2015

Paneli ka vazhduar të angazhohet në një fushatë të gjerë në terren për të informuar publikun në lidhje me Panelin. Fushata informuese është kryer në përputhje me Dokumentin e Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009, ndër të tjera pohohet në paragrafin E, se "... EULEX-i Kosovë do të siguroj shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile ka deklaruar në paragrafin 3 të Udhëzimit të tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin se Udhërrëfyesi për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale duhet të përfshijnë, ndër të tjera "përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënies me publikun".



Siç thuhet në Raportet e mëparshme Vjetore, nga qytetarët vazhdon të ketë mungesë të përgjithshme informimit rreth Panelit, mandatit dhe punës së tij. Kjo është më e theksuar në zona rurale. Në këtë kontekst, Paneli dhe Sekretariati kanë përqendruar përpjekjet në kryerjen e shumë aktivitete informuese në ato fusha të identifikuara. Vazhdimi i fushatës së mëparshme të reklamave në TV dhe radio të kryera nga Paneli do të ndihmojë në masë të madhe Panelin në përpjekjet e tij për të pasur qasje tek qytetarët e zonës urbane dhe rurale.

Përqendrimi kryesor i fushatës informuese gjatë vitit ka qenë tek OJQ-të, përfaqësues të shoqërisë civile, kishë dhe organet e tjera fetare. Si pjesë e kësaj strategjie, Paneli dhe Sekretariati kanë rritur përqendrimin e tyre në veri të Mitrovicës në përpjekje që të zgjerojnë dukshmërinë në atë zonë.

Sekretariati i shoqëruar nga një anëtar i Panelit është takuar me koordinatorin e zyrës për Kosovë dhe Metohi, në veri të Mitrovicës me 16 qershor. Koordinatori ishte informuar mbi aktivitetet e fundit të Panelit sa i përket çështjeve të interesit dhe shqetësimit të përbashkët.

Përveç kësaj, Paneli dhe Sekretariati gjithashtu gjatë fushatës informuese kanë bërë një udhëtim në Beograd nga data 6 deri me 8 dhjetor, ku janë takuar me shefin e Grupit për Drejtësi, të Drejta të Njeriut dhe të Drejtave të Pronësisë, Zyra për Kosovë dhe Metohi, këshilltar, Departamenti i Çështjeve Ligjore, Zyra për Kosovë dhe Metohi dhe kryetarin e Komisionit për Persona të pagjetur dhe koordinatorin, Zyra për Persona të pagjetur, Qeveria e Republikës së Serbisë.

Po ashtu Paneli është takuar me udhëheqësin e ekipit dhe zëvendës udhëheqësin e ekipit të agjencisë për zbatimin e Projektit për Mbështetje të mëtutjeshme të refugjatëve dhe personave në zhvendosur në Serbi, (Europaid/129209/C/SER/RS), projekt i financuar nga BE-ja. Projekti i fundit Europaid/129209/C/SER/RS ka përfunduar në fund të vitit 2015 dhe projekti i ri do të rinis për një mandat tjetër dyvjeçar në prill të vitit 2016.

Paneli ka mbajtur një takim me shefin e Policisë Ekzekutive dhe Komandë të CIVPOL-it të EULEX-it me 21 maj. Përveç kësaj, një takim hyrës është mbajtur me shefin e personelit të EULEX-it me 12 nëntor.

## **6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it**

Sekretariati ka vazhduar të marrë pjesë në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për pjesëtarët e rinj të personelit të EULEX-it. Formatit përbëhet nga një prezantim që bëhet nga Paneli me një kohë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky është një forum shumë i dobishëm për të informuar personelin e ri rreth mandatit të Panelit dhe për të rritur paraqitjen e Panelit tek personeli i EULEX-it në zonën e misionit.

Paneli e konsideron këtë element të një rëndësie të veçantë për shkak se i ofron Panelit një mundësi që të sigurohet se personeli i ri i EULEX-it informohet rreth obligimeve të tyre në përmbushjen e standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së funksionit të tyre dhe implikimeve në llogaridhënie sa i përket shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ekzekutive.

### **6.3. Faqja e internetit e PShDNj-së**

Sekretariati mirëmban faqen e internetit të Panelit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu). Kjo faqe përmban informata rreth mandatit dhe funksioneve të Panelit, si dhe informata të përditësuara rreth aktiviteteve, seancave të Panelit, si dhe statusit të tanishëm të lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara.

Po ashtu të gjitha vendimet e marra nga Paneli gjendjen aty. Tabela e jurisprudencës së Panelit ofron qasje në numrin në rritje të lëndëve sipas lëndëve (sipas pranueshmërinë po ashtu edhe sipas përmbajtjes) dhe ajo është krijuar për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankues dhe avokatë.

Faqja e internetit gjithashtu ofron informacione mbi standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut, si dhe aty gjenden formularët e aplikimit dhe udhëzimet për parashtrimin e ankesave.

E gjithë faqja është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Në vitin 2015 faqja e internetit e Panelit është vizituar prej më shumë se 7000 përdoruesve.

Që nga viti 2014 Paneli po ashtu ka profil në Facebook.

## **7. Çështjet operative/administrative**

### **7.1. Buxheti**

Në vitin 2015, si në vitet e mëparshme Panelit i është ndarë një buxhet i veçantë për fushatën informuese dhe materiale promovuese. Ky është një hap i mirëpritur, i cili i mundëson Panelit të marrë vendimet e veta në zgjerimin e fushatës informuese, posaçërisht në transmetimet në TV dhe/ose në radio transmetime, pa mbështetje prej burimeve nga EULEX-i Kosovë.

Megjithatë, diskrecioni shtesë buxhetor do t'i ndihmoj në masë të madhe Panelit gjatë punës të tij të përditshëm. Kjo do të rrisë edhe më tej pavarësinë e vërtetë dhe të perceptuar të Panelit dhe në këtë mënyrë edhe më tej e rritë besueshmërinë e misionit të EULEX-it dhe angazhimin e tij ndaj të drejtave të njeriut.

### **7.2. Personeli i Sekretariatit**

Në vitin 2015, Sekretariati i Panelit kishte pasur probleme me personelin. Ishte dashur që Sekretariati të punoj vetëm me një zyrtar ligjor për katër muajt e parë të vitit, dy zyrtarë ligjorë për rreth tre muaj dhe personel të plotë prej tre zyrtarëve ligjorë nga muaji gusht.

## **8. Komentim ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut dhe çështjet që lidhen me to në Kosovë**

### **8.1. Pjesë e shkëputur e raportit të Grupit Punues, Këshillit të të Drejtave të Njeriut, Kombeve të Bashkuara rreth zhdukjeve me forcë apo të**

## **pavullnetshme, Asambleja e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, 17 gusht 2015**

*"UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje shtesë për të inkurajuar vazhdimin efikas të hetimeve (të krimeve të luftës) që janë nisur para bartjes së kompetencave nga UNMIK-u tek EULEX-i ...*

*... Duke njohur natyrën sfiduese të punës së hetimit të krimeve të luftës dhe ndjekjes penale dhe përpjekjeve të bëra (deri më sot) EULEX-i Kosovë duhet të hetoj të gjitha rastet e pazgjdhura të zhdukjeve dhe të sjellë autorët para drejtësisë ...*

*... Grupi Punues ka kërkuar nga qeverinë e Serbisë, autoritetet në Kosovë dhe shefat e misioneve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë që brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së këtij raporti në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të paraqesin një orar që tregon hapat që ata do të ndërmarrin për të zbatuar rekomandimet e Grupit Punues, datat me të cilat do të ndërmerret secila masë dhe datat me të cilat kanë plan për të përfunduar zbatimin e rekomandimeve"<sup>3</sup>.*

### **Përmbledhje**

Grupi Punues për personat e zhdukur me forcë dhe në mënyrë të pavullnetshme ka vizituar Serbinë, Kosovën, Kroacinë dhe Malin e Zi nga data 19 deri me 26 qershor 2015, kurse raporti i tyre është publikuar me 17 gusht 2015. Duke pasur parasysh kohën që ka kaluar prej se kanë ndodhur zhdukjet me forcë e po ashtu edhe moshën e shtyrë e shumë dëshmitarëve, të afërmeve dhe autorëve të krimit, u vlerësua se ishte nevojë urgjente për ata që janë të përfshirë në kërkim të personave të zhdukur në rajon që të vendosin si prioritet të menjëhershëm vërtetimin e së vërtetës, në veçanti të përcaktohet fati dhe vendndodhja e personave të zhdukur.

Grupi Punues ishte i shqetësuar që bashkëpunimi rajonal ishte përshkruar me mosbesim të dyanshëm. Prandaj ai i bëri thirrje atyre që ishin të përfshirë që të nxisnin besimin dhe promovojnë bashkëpunimin rajonal, pajtimin ndëretnik dhe kohezionit social. Grupi Punues ka theksuar se bashkëpunimi i suksesshëm kërkon angazhim të qartë dhe të fortë politik në nivelet më të larta nga akterët politikë.

Grupi i Punës theksoj se zhdukjet me forcë duhet të vendosen si vepër e veçantë në legjislacionin vendor. Grupi Punues i bëri thirrje autoriteteve në Kosovë si në vijim: të vazhdojnë përpjekjet e tyre në kërkim të personave dhe identifikimin e mbetjeve mortore; të ofrohet ndjekja efikase e krimeve të luftës në përputhje me standardet ndërkombëtare; të zbatohen të gjitha masat e nevojshme për të luftuar mosndëshkimin dhe për të ngritur një program gjithëpërfshirës dëmshpërblimi.

Grupi Punues ishte i mendimit se organet ndërkombëtare, UNMIK-u dhe EULEX-i Kosovë, si administratorë të përkohshme civilë në Kosovë, duhet të mbahen përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. Grupi Punues gjithashtu i bëri thirrje organeve të lartpërmendura ndërkombëtare për të lehtësuar kërkimin e personave të zhdukur dhe për të siguruar hetimin efektiv dhe ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për krime lufte.

Metodologjia e përdorur nga Grupi Punues përbëhet nga një vlerësim i gjendjes në Kosovë sa i përket gjendjes së gjyqësorit dhe prokurorisë sipas ligjit në fuqi. Ky vlerësim ishte kryer nën këto

---

<sup>3</sup>Asambleja e Përgjithshme, Kombet e Bashkuara, Raporti i Grupit Punues për personat e zhdukur me forcë dhe në mënyrë të pavullnetshme, 17 gusht 2015, par. 142, 143 dhe 146.

tituj kryesor: korniza ligjore; e drejta për të vërtetën; e drejta për drejtësi dhe të drejta e dëmshpërblimit.

Grupi Punues ka vlerësuar shërbimet e mjekësisë ligjore, shërbimet e përkujdesjes, programet për mbrojtjen e dëshmitarëve, pranueshmërinë e provave, dëmshpërblimin dhe kompensimin. Vlerësimi ka përfshirë rekomandimet e drejtuara drejt qeverisë së Kosovës dhe Serbisë dhe drejt autoriteteve ndërkombëtare, UNMIK-ut dhe EULEX-it Kosovë. Grupi Punues ka përfunduar vlerësimin e tij me një listë të plotë konkluzionesh.

### **Korniza ligjore**

Grupi Punues ka deklaruar se zhdukja e dhunshme ende nuk është përfshirë si një krim autonom në legjislacionin penal të Kosovës, edhe pse Kushtetuta e Kosovës e njeh zbatueshmërinë e deklaratave standarde të të drejtave të njeriut, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për të Drejtat e Njeriut për periudhën 2009-2011 bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes së të drejtave të njeriut që përfshinte çështjet që lidheshin me zhdukjet dhe personat e zhdukur.

Autoritetet në Kosovë kanë informuar Grupin Punues për ligjet e tjera, siç është Ligji për Dëshmitarë dhe Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, ndërsa dy ligje janë miratuar që rregullojnë statusin e personave të zhdukur dhe garantojnë të drejtat e viktimave në Kosovë.

Ligji që rregullon statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre përcakton statusin dhe mbështetjen financiare në dispozicion për ata persona.

Ligji për Personat e zhdukur ka për qëllim të mbroj të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarët e tyre, në veçanti të drejtën e anëtarëve të familjes që të njoftohen për fatin e të afërmve të tyre të zhdukur. Ligji gjithashtu përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Personat e zhdukur.

### **E drejta për të vërtetën**

Anëtarët e familjes dhe përfaqësuesit e shoqatave të familjeve të personave të zhdukur kanë shprehur frustrimin e tyre për vështirësitë që ata hasin atëherë kur përpiqen të kenë qasje në informata që ata kërkojnë për të përcaktuar fatin dhe vendndodhjen e të afërmve të tyre.

Mungesa e informacionit të saktë mbi vendndodhjen e varrezave të pagjetura përbën një nga pengesat më të mëdha për zbulimin e fatit dhe vendndodhjen e personave të zhdukur. Grupi Punues ka njoftuar se autoritetet serbe besohet se posedojnë më shumë informata sesa që janë paraqitur në dokumentacionin e zbuluar deri më sot. Po ashtu ekziston një perceptim i përbashkët në Kosovë se ushtria serbe ka shënime të plota të vendndodhjes së varrezave, mirëpo nuk ju është ofruar qasje e plotë në arkivat e tij.

Gjithashtu besohet se as qeveria e Kosovës nuk ka ofruar qasje të plotë në informacionin e saj. Ngurrimi i dëshmitarëve për të dhënë informacion për shkak të kërcënimeve, frikësimit, një ndjenje të rreme të lojalitetit apo frike se ata mund të implikojnë veten në një krim të supozuar paraqet vështirësi shtesë.

Në lidhje me identifikimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur, gabimet e hershme në procedurë kanë rezultuar me sfida të mëdha në identifikimin e tyre gjatë zvarrosjes së fundit. Në

këtë aspekt, nuk janë identifikuar ende eshtrat e rreth 300 personave në morgun e Prishtinës. Sipas Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, 412 profile të paidentifikuar individuale të ADN-së nga Kosova nuk përputhen me asnjërën nga mostrat e gjakut në bazën e të dhënave. Kjo konfirmon dyshimin se gabimet kanë ndodhur gjatë procesit të identifikimit në vitet e hershme, posaçërisht pasi që procesi i identifikimit ishte bazuar në metodat tradicionale, jo-shkencore.

EULEX-i Kosovë mbështet punën e Departamentit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në zhvarrosjen dhe identifikimin e trupave. Me 30 tetor 2014, personeli i EULEX-it Kosovë që punon për Departamentin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës ka ekzekutuar një vendim gjykate në varrezat e Qabratit në Gjakovë, ku ka zhvarrosur 14 varre, me qëllim të identifikimit të saktë të mbetjeve që ishin gjetur në Serbi në vitin 2001.

Ata që ishin varrosur në varrezat e Qabratit dhe të tjerët që ishin varrosur në Klinë dhe Malishevë kryesisht janë viktimat të shqiptarëve të Kosovës të ngjarjeve në Gjakovë dhe Kralan dhe janë të lidhura me më shumë se 50 raste të tjera të tilla të personave që ende konsiderohen të zhdukur.

Këto mbetje mortore ishin dërguar në Departamentin e Mjekësisë Ligjore për identifikimin e mëtejshëm dhe analiza të ADN-së. Atëherë kur procesi të përfundoj, Departamenti në fjalë do t'i dorëzoj të gjitha mbetjet e identifikuar mortore familjeve të tyre.

Nismat e ndërmarra nga shoqëria civile për të kërkuar dhe zbuluar të vërtetën përfshinë mbledhjen e provave, të dhënat dhe tregimet që mund të kontribuojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Disa organizata kanë vendosur edhe përmendore që ofrojnë një vend për familjet e viktimave për të treguar publikisht historitë e tyre dhe për t'i mbajtur në mend më të dashurit e tyre.

## **E drejta për drejtësi**

Kompleksiteti i situatës politike të pas konfliktit kontribuon shumë në sfidat që lidhen me ndjekjen penale të krimeve të luftës në Kosovë. UNMIK-u ishte themeluar në qershor 1999 në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 me një mandat për të ofruar një zgjidhje politike të krizës së Kosovës. Si prani ndërkombëtare e administratës civile, UNMIK-u ka pasur autoritet mbi territorin dhe popullatën e Kosovës, duke përfshirë edhe pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, si dhe administrimin e gjyqësorit dhe policisë.

Grupi Punues është i shqetësuar në lidhje me informacionin që i është dhënë, që tregon se rastet e zhdukjeve me forcë dhe personave të zhdukur nuk janë hetuar siç duhet nga UNMIK-u. Më tej Komisioni i të Drejtave të Njeriut ka ngritur shqetësime në lidhje me dështimin e UNMIK-ut për të hetuar në mënyrë efektive shumë nga krimet e kryera para mandatit të UNMIK-ut, si dhe dështimi për të sjellë autorët në fjalë para drejtësisë.

Në mënyrë të ngjashme, Grupi Punues ka vënë në dukje me shqetësim se Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut ka vendosur në disa raste se hetimi i zhdukjeve të detyrura dhe personave të zhdukur të kryera nga UNMIK-u ka dështuar që të përmbush standardet minimale të një hetimi efektiv në përputhje me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Grupi Punues ka vlerësuar se dështimet nga UNMIK-u në këtë drejtim duhet të adresohen si duhet dhe viktimat e këtyre dështimeve duhet të kompensohen nga Kombet e Bashkuara.

Mandati i UNMIK-ut ishte modifikuar në mënyrë të konsiderueshme në dhjetor të vitit 2008 në një kohë kur EULEX-i Kosovë ka marrë kompetenca ekzekutive në drejtësi, polici dhe dogana. Ndjekja penale e krimeve të luftës që atëherë është kryer nga Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës e EULEX-it Kosovë dhe nga prokurorët e EULEX-it Kosovë.

Grupi Punues vlerëson se dështimet e pretenduara nga ana e gjyqësorit të UNMIK-ut në vitet e para nuk mund të shërbejnë tani për të shfaqësorët prokurorët dhe hetuesit e EULEX-it Kosovë për përgjegjësitë e tyre në rrethana të tilla. As kalimi i kohës nuk mund të ofrohet si justifikim. Prandaj, Grupi i Punës i bën thirrje EULEX-it Kosovë që të dyfishoj përpjekjet e tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar qasje në drejtësi për viktimat.

Në atë kohë UNMIK-u ka bartur një numër të madh të dosjeve të lëndëve rreth personave të zhdukur tek EULEX-it në atë kohë. Është supozuar se disa nga këto lëndë nuk ishin të dokumentuara mirë dhe se nuk ka pasur hetim fillestar në disa lëndë. Grupi Punues gjithashtu ishte informuar se EULEX-i Kosovë kishte rekrutuar dy prokurorë shtesë në vitin 2013 dhe që gjyqtarët e EULEX-it Kosovë kanë kompetencë mbi gjykimet penale që kanë të bëjnë me luftën.

Megjithatë, vetëm një numër i kufizuar i lëndëve janë gjykuar secilin vit pavarësisht përpjekjeve të bëra deri më sot për t'i përmirësuar gjërat. Në veçanti, Grupi Punues ishte njoftuar se ishte arritur pak progres në hetimin dhe ndjekjen penale të rrëmbimeve që kanë ndodhur në kulmin e konfliktit në vitin 1999. Grupi Punues ishte informuar gjithashtu se nuk ishin nisur hetime të reja nga ana e EULEX-it që nga 15 prilli 2014, përveç në atë që është quajtur "rrethana të jashtëzakonshme".

Megjithatë, një nismë e rëndësishme në këtë drejtim ka ndodhur me vendimin për të krijuar një Dhomë Speciale dhe një Zyre të prokurorisë speciale në prill 2014. Kjo gjykatë do të gjykojë lëndët, përfshirë rrëmbimet që thuhet se janë kryer gjatë konfliktit nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1999 dhe 2000. Grupi Punues ka përshëndetur faktin se me 3 gusht 2015 Kuvendi i Kosovës ka miratuar një amendament kushtetues, i cili ka hapur rrugën për krijimin e kësaj gjykate.

Një nga sfidat kryesore me të cilat hetuesit ballafaqohen është se dëshmitarët kryesorë nuk janë të gatshme të ofrojnë dëshmi kundër autorëve të mundshëm. Për më tepër, mungesa e një programi efektiv për mbrojtjen e dëshmitarëve dekurajon dëshmitarët që të ofrojnë dëshmi, sidomos pasi që lojaliteti ndaj familjes dhe klanit në këto rrethana është kryesorja.

Megjithatë, në mënyrë të veçantë Grupi Punues ka përshëndetur përpjekjet e EULEX-it Kosovë për të siguruar mbrojtje për dëshmitarët në rastet me rrezik të lartë duke i përfshirë ata në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe ka theksuar rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të këtij programi.

Grupi Punues gjithashtu ka vënë në dukje se në mungesë të një kornize ligjore formale për të autorizuar gjykatat në Kosovë që të përdorin dëshmitë e marra nga Gjykata Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjNIJ) një dëshmi e tillë është përdorur ad hoc nga prokurorët ndërkombëtarë të EULEX-it Kosovë.

Grupi Punues ka shprehur shqetësimin se drejtësia duket të lihet në vullnetin e mirë të akterëve politik përkatës. Kosova nuk duhet të jetë në një vakum të tillë ligjor dhe Grupi Punues ka deklaruar se të paktën ata që ishin më përgjegjës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përfshirë zhdukjet, duhet të ndiqen penalisht.

Në fund dhe si pikë e rëndësishme, Grupi Punues ka vënë në dukje me shqetësim se shumë autorë të supozuar të krimeve të luftës tani zënë pozita të nivelit të lartë të autoritetit në qeverinë e Kosovës, etj.

### **E drejta për kompensim**

Shumë viktima në Kosovë nuk kanë marrë dëmshpërblimin adekuat për vuajtjet e tyre. Kompensimi në rastet e zhdukjeve me forcë përfshin jo vetëm kompensimin në të holla, por gjithashtu përfshin qasjen në kujdesin shëndetësor, përfitimet sociale, ndihmën ligjore dhe programet rehabilituese.

Grupi Punues ka thënë se pensioni prej 168 eurosh në muaj për viktimat i lë shumë familje në varfëri. Grupi Punues gjithashtu ka thënë se pengesa administrative shpesh i kufizon disa viktimat në të drejtat e tyre për shkak të vështirësive me dokumentacion, afate të shkurta për paraqitjen e kërkesave, personel jo bashkëpunues dhe probleme me gjuhë, pasi shumë zyrtarë nuk e flasin gjuhën serbe.

Përveç kësaj, disa familje të viktimave të zhdukjeve me forcë jetojnë në të njëjtin komunitet me autorët e supozuar të këtyre zhdukjeve. Përderisa Grupi Punues nuk ka marrë ndonjë raport lidhur me ngacmimet e rënda, familjet e viktimave ndjehen rishtas të traumatizuar nga ky fakt. Autoritetet në Kosovë duhet të lehtësojnë dhe mbështesin rehabilitimin e familjeve të viktimave të zhdukjeve dhe të marrin masat e nevojshme për t'iu mundësuar atyre të jetojnë në një mjedis të favorshëm rehabilitues.

### **Rekomandime për UNMIK-un dhe EULEX-in Kosovë**

- UNMIK-u dhe EULEX-i Kosovë duhet të angazhohen me mekanizmat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me qëllim të adresimit të çështjeve që lidhen me zhdukjet me forcë.
- Organet ndërkombëtare që veprojnë si administratorë të përkohshëm në Kosovë duhet të mbahen përgjegjës për shkeljet e të drejtave të tyre të njeriut.
- Të gjitha organizmat ndërkombëtarë që mbajnë informacione të rëndësishme në lidhje me rastet e zhdukjeve me forcë që kanë ndodhur gjatë dhe menjëherë pas viteve 1998-1999 të ngjarjeve në Kosovë duhet të hapin arkivat e tyre dhe lehtësojnë kërkimet dhe hetimet.
- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) duhet të vazhdojë të kryesojë Grupin Punues për Persona të Zhdukur dhe të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin në rajon. KNKK-ja duhet edhe më tej të forcojë dhe zgjerojë nismat e veta.
- Grupi Punues për Persona të Zhdukur duhet të takohen më shpesh. Në ndërkohë, Grupi Punues inkurajon UNMIK-un, si vëzhgues i këtij organi, të vazhdojë të luajë rol aktiv.
- UNMIK-u duhet të kërkojë mjete të përshtatshme për ofrimin e kompensimit viktimave të abuzimeve të së drejtave të njeriut, të identifikuar nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht në lidhje me hetimet joefektive të supozuara në rastet e personave të zhdukur.
- UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje shtesë për të inkurajuar vazhdimin efektiv të hetimeve që janë nisur para bartjes së pushtetit nga UNMIK-u në EULEX Kosovë.
- Duke pranuar natyrën sfiduese të punës së hetimit të krimeve të luftës dhe ndjekjes penale dhe përpjekjet e bëra deri më tani, EULEX-i Kosovë duhet të hetojë të gjitha rastet e pazgjidhura të zhdukjeve dhe të sjellë autorët para drejtësisë.
- Në mënyrë që të nxitet dhënia e dëshmimeve, EULEX-i Kosovë në bashkëpunim me autoritetet në Kosovë duhet të krijojë një program efektiv dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përfshirë edhe ndihmën për rivendosje.
- Vendosja e bashkëpunimit të ngushtë dhe investimi i më shumë burimeve në ndërtimin e kapaciteteve për zyrtarët vendorë të policisë, prokurorëve, gjyqtarëve dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore, duke përfshirë arkeologët e mjekësisë ligjore dhe antropologët e mjekësisë ligjore.
- Të sigurohet që serbët etnik të marrin pjesë në kurse trajnimi.

### **Rekomandimet për Qeverinë e Serbisë**

- Të vendoset zhdukja me forcë si vepër e veçantë penale, në përputhje me definicionin përfshirë në Deklaratën për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë. Vepra e zhdukjes me forcë duhet të jetë e dënueshme me dënime të duhura duke marrë parasysh seriozitetin e krimeve të tilla.

- Të njihet statusi i familjeve të personave të zhdukur me ligj dhe të garantohen të drejtën e tyre në mënyrë jo-diskriminuese.
- Të vendoset një sistem efektiv publik i ndihmës juridike falas për të lejuar familjarët e personave të zhdukur të marrë asistencë ligjore në qoftë se ata nuk mund ta përballojnë atë.
- Të sigurohet një qasje e ndjeshme ndaj aspektit gjinor kur hartohen dhe zbatohen programet për kompensim, me qëllim të adresohet pabarazia gjinore.
- Të miratohet një strategjie shtetërore e të drejtave të njeriut apo plan veprimi shtetëror për të drejtat e njeriut për të adresuar çështjen e personave të zhdukur në mënyrë gjithëpërfshirëse.
- Të forcohen dhe sistemohen programet e mbrojtjes së dëshmitarëve për t'u siguruar që ato janë gjithëpërfshirëse.
- Të sigurohet që kompensimi të jetë në dispozicion për të gjitha viktimat e zhdukjeve me forcë. Kompensimi nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm për viktimat e forcave të armikut. Serbia duhet të marrë parasysh vendosjen e ndryshimeve të nevojshme legislative në mënyrë që të zgjerohet definicioni i viktimës.
- Të sigurohet që të gjitha viktimat e zhdukjeve me forcë të marrin dëmshpërblim të plotë, duke përfshirë kthimin, rehabilitimin, marrjen dhe garancitë e mospërsëritjes, pa diskriminim dhe pa pasur nevojë që ta shpallin të vdekur personin e zhdukur.
- Të sigurohet shpërndarje e barabartë e burimeve ekzistuese për viktimat civile të luftës për të çrrënjësuar diskriminimin, ndër të tjera midis buxhetit për viktimat civile dhe ushtarake të luftës.
- Të rritet ndërgjegjësimi publik për ndjekjen e krimeve të luftës, përfshirë hetimet në rastet e zhdukjeve me forcë, në mënyrë që të zvogëlohen ndjenjat negative rreth procedurave të krimeve të luftës.
- Të vendosen konsultime të rregullta me familjet e viktimave të zhdukjeve me forcë dhe përfaqësues të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur.
- Të sigurohet mbështetje më e madhe institucionale dhe financiare për familjet dhe shoqatat e familjeve të viktimave të zhdukjeve me forcë.
- Të shpallet ligji për qasje në informata dhe një kornizë e duhur ligjore në arkiva, në mënyrë që të garantohet qasje e plotë në të gjitha informatat që potencialisht mund të çojnë drejt qartësive rreth rasteve të personave të zhdukur.
- Të hetohen pa vonesë të gjitha lokacionet e vendeve të mundshme të varrezave masive.
- Të adresohen keqidentifikimet e mundshme të bëra në të kaluarën, me kusht që e drejta e privatësisë së familjeve të viktimave të zhdukjeve plotësisht të respektohet dhe se të dhënat e ADN-së të mbrohen me kujdes maksimal. Një proces i shqyrtimit duhet të nisë për të hequr pengesat në punën e vazhdueshme për identifikim.
- Të përshpejtohet procesi i ndjekjeve penale të krimeve të luftës.
- Të nisë një proces verifikimi për të identifikuar të gjithë zyrtarët qeveritarë të cilët dyshohet se ishin të përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës. Të përmirësohen dhe sistematizohen masat e verifikimit në rekrutimin dhe emërimin e zyrtarëve të shtetit.
- Të kryhen negociata efektive dhe të arrihet një marrëveshje për rastet e krimeve të luftës me autoritetet e Kosovës për të krijuar një protokoll operativ për bashkëpunim në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës.
- Të sigurohet liria e medias dhe të përdoren mjetet e komunikimit masiv për të ngritur ndërgjegjësimin rreth çështjes së personave të zhdukur në rajon.
- Të kushtohet vëmendje e barabartë për të gjitha viktimat, pavarësisht nga kombësia e tyre sa i përket përmendoreve. Ky parim duhet të integrohet në aktivitetet e ardhshme që lidhen me këto elemente të dëmshpërblimit.
- Të punohen materiale mësimore që promovojnë pluralizmin dhe që ju mësojnë historinë në mënyrë objektive, në mënyrë që të luftohet polarizimi etnik dhe diskriminimi etnik.



## Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës

- Të intensifikohen përpjekjet në kërkimin e personave të zhdukur dhe identifikimin e mbetjeve mortore që janë zhvarrosur.
- Të kërkohet asistencë teknike nga organet ndërkombëtare që veprojnë në terren për të kryer reformat institucionale që synojnë krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe efikas.
- Të kryhen negociata efektive dhe të arritët një marrëveshje për rastet e krimeve të luftës me autoritetet serbe për të krijuar një protokoll operativ për bashkëpunim në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës.
- Të bëhen marrëveshje bashkëpunimi me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë të përfshirë në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit teknik, të tilla si marrjen e dëshmimeve, deklaratave dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me luftën në Kosovë.
- Të mbahen konsultime me shoqatat e familjeve të personave të zhdukur, organizatave të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë përkatës në krijimin e një regjistri qendror për personat e zhdukur për të siguruar që ai përmban gjithë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar sqarimin e fatit dhe vendndodhjen e personave të zhdukur në një mënyrë transparente, gjithpërfshirëse dhe konsultative.
- Të angazhohen grupet e pakicave dhe të sigurohet që ata të përfaqësohen në mënyrë të duhur në Komisionin për Personat e Zhdukur. Komisioni duhet të siguroj zbatimin në praktikë të parimit të mosdiskriminimit.
- Të angazhohen shoqatat e familjeve të personave të zhdukur dhe të inkurajohen që të emërojnë anëtarët e Komisionit për Persona të Zhdukur.
- Të organizohen përkujtime të përbashkëta për viktimat e personave të zhdukur nga të gjitha përkatësitë etnike.
- Të miratohet një lig mbi përdorimin në Kosovë të dëshmimeve të mbledhura nga Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në mënyrë që të sigurohet që dëshmitë e mbledhura nga Tribunali do të vazhdojnë të jenë të pranueshme pas bartjes së mandatit të gjykatave dhe prokurorëve vendorë, duke mbrojtur rregullat e konfidencialitetit.
- Të hapen menjëherë arkivat përkatëse në rastet e zhdukjeve me forcë që kanë ndodhur gjatë dhe menjëherë pas viteve 1998-1999 të ngjarjeve në Kosovë për të lehtësuar identifikimin e varrezave të pazbuluara dhe për të përshpejtuar kërkimin.
- T'ju sigurohet familjeve të personave dëmshpërblim i duhur dhe efektiv.
- Të mbahen konsultime me viktimat nga të gjitha grupet etnike për të dëgjuar pikëpamjet e tyre mbi natyrën specifike të dëmshpërblimit që ata kanë nevojë. Sipas nevojës duhet të ofrohet mbështetje në aspektin e gjuhës.
- Të sigurohet që të gjitha viktimat e zhdukjeve me forcë të marrin dëmshpërblim të plotë, duke përfshirë kthimin, rehabilitimin, bindjen dhe garancitë e mospërsëritjes, pa diskriminim dhe pa pasur nevojë për ta shpallur personin e zhdukur të vdekur.
- Të vendoset dhe të zbatohet në mënyrë efektive një program gjithëpërfshirës për mbrojtjen e dëshmitarëve, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.
- Të miratohet një qasje e ndjeshme ndaj aspektit gjinor kur hartohen dhe zbatohen programet për kompensim, me qëllim të adresimit të pabarazisë gjinore. Ndihma për rivendosje duhet të jepet në rastet kur viktimat jetojnë në të njëjtin komunitet me autorët e supozuar për të lehtësuar rehabilitimin e viktimave dhe për t'i parandaluar që ata prapë të traumatizohen.
- Të adresohen keqidentifikimet e mundshme të bëra në të kaluarën, me kusht që e drejta e privatësisë së familjeve të viktimave të zhdukjeve plotësisht të respektohet dhe se të dhënat e ADN-së të jenë të mbrojtura me kujdes maksimal. Një proces rishikimi duhet të nisë për të hequr pengesat në punën e vazhdueshme për identifikim.

- Të sigurohet liria e medias dhe të përdoren mjetet e komunikimit masiv për të ngritur ndërgjegjësimin rreth çështjes së personave të zhdukur në rajon. Të punohen materiale mësimore që promovojnë pluralizmin dhe që ju mësojnë historinë në mënyrë objektive, në mënyrë që të luftohet polarizimi etnik dhe diskriminimi etnik.
- Të krijohet një proces i fortë i verifikimit për të siguruar që autorët e dyshuar të krimeve të luftës nuk emërohen në pozita me autoritet.

### **Konkluzionet e Grupit Punues**

Duke pasur parasysh periudhën kohore që ka kaluar prej se kanë ndodhur zhdukjet në vitin 1999 dhe 2000 si dhe moshën e shtyrë të shumë të afërmeve dhe dëshmitarëve, ekziston një nevojë urgjente për ata që janë përfshirë në kërkim të personave të zhdukur që të vendoset prioritet i menjëhershëm përcaktimi i së vërtetës dhe në veçanti përcaktimi i fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur.

Çështja e zhdukjeve duhet të konsiderohet si një çështje e të drejtës humanitare dhe çështje e të drejtave të njeriut. Në mënyrë të veçantë, ajo duhet të jetë në agjendën e dialogut të Beogradit dhe Prishtinës të lehtësuar nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë.

Grupi Punues ka pranuar se Kombet e Bashkuara dhe organet e tjera ndërkombëtare nuk kanë adresuar në mënyrë të duhur një numër çështjesh lidhur me personat e zhdukur dhe se bashkësia ndërkombëtare është gjithashtu përgjegjës për mungesën e së vërtetës, drejtësisë dhe dëmshpërblimit.

Grupi Punues ka pranuar bashkëpunimin e nivelit punues që zhvillohet në mes të ekspertëve të mjekësisë ligjore, prokurorëve dhe gjyqtarëve në gjithë rajonin. Megjithatë duhet të rritet niveli i bashkëpunimit përfshirë edhe bashkëpunimit mes UNMIK-ut dhe EULEX-it Kosovë, si dhe qeverisë së Kosovës dhe Serbisë duhet të rritet. Bashkëpunimi i suksesshëm kërkon angazhime të qarta dhe të forta politike nga nivelet më të larta të të gjitha palëve të interesit.

Aktualisht bashkëpunimi rajonal është dëmtuar nga mosbesimi reciprok që ndër të tjera ka vonuar zhvarrosjen. Prandaj ndërtimi i besimit në mes të palëve të interesuara është i një rëndësie të lartë, palët duhet të kontribuojnë në këtë proces duke lënë pas armiqësinë dhe duke nxitur një mjedis mirëbesimi që do të promovojë edhe më tej bashkëpunimin rajonal.

Në ndërkohë, duhet gjykim i pjekur politik dhe udhëheqje politike e vendosur për të promovuar pajtimin ndëretnik dhe kohezionin social që përfundimisht mund të ndihmoj të përcaktohet e vërteta në rajon.

Grupi Punues ishte i pikëlluar thellë nga vuajtjet e pabesueshme që të afërmit e personave të zhdukur durojnë dhe kanë duruar që nga viti 1999 dhe 2000. Me shpresë se kjo mund të kontribuojë në zgjidhje të këtij problemi, Grupi Punues ka përsëritur ofertën e tij për ndihmë dhe bashkëpunim në të ardhmen me të gjitha palët e interesuara.

Më në fund Grupi Punues ka dëshiruar të përmend vlerësimin e tij për gjithë bashkëpunimin dhe ndihmën, të cilën e ka marrë nga palët e interesuara gjatë vizitës së tij.

## **8.2. Prezantimi publik dhe Analiza e vendimeve të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut - Përgjegjësia e Kombeve të Bashkuara (UNMIK-ut) për Zhdukjet me forcë dhe vrasjet e serbëve në Kosovë**

*(Pjesë e shkëputur nga Raporti mbi koordinimin e shoqatave serbe të familjeve të personave të zhdukur – territori i ish-Jugosllavisë, 20 nëntor 2015)*

### **Hyrje**

Koordinimi i shoqatave serbe të familjeve të personave të zhdukur nga territori i ish-Jugosllavisë (Koordinimi) ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët në Beograd me 20 nëntor 2015 me temën: “Përgjegjësia e Kombeve të Bashkuara (UNMIK-ut) për zhdukjet me forcë apo të pavullnetshme dhe vrasjet e serbëve në Kosovë dhe Metohi”.

### **Konkluzione mbi përgjegjësitë dhe obligimet e UNMIK-ut dhe EULEX-it Kosovë**

1. Koordinimi ka shprehur vlerësimin e tij për Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj) ndaj shqyrtimit të ankesave të shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u gjatë administrimit të tij civil në Kosovë.

Ai ka vënë në dukje se PKDNj-ja kishte përcaktuar 155 shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) dhe 71 shkelje të nenit 2 të KEDNj-së.

Koordinimi ka kritikuar vendimin e UNMIK-ut për të caktuar afat kohor për parashtrimin e ankesave të tilla deri me 31 mars 2010. Kjo vendosje e afatit ka ndikuar në përjashtimin e rreth 400 ankesave të tjera të mundshme të shkeljes së të drejtave të njeriut në bazë të neneve 2 dhe 3 të KEDNj-së.

2. Koordinimi ka pohuar se UNMIK-u, si shtet surrogat, me një prani ndërkombëtare të administratës civile nuk ka zbatuar përgjegjësinë e vet me mandat për të mbrojtur të drejtën e jetës:

... “se UNMIK-u nuk e ka penguar spastrimin në masë dhe të organizuar etnik, zhdukjet me forcë apo të pavullnetshme, vrasjet, trajtimet çnjerëzore dhe torturimin e serbëve dhe joshqiptarëve të tjerë në Kosovë dhe Metohi, të kryera pas 10 qershorit 1999 nga anëtarët e të ashtuquajturës Ushtria Çlirimtare e Kosovës”<sup>4</sup> ...

... “se në rastet e zhdukjeve me forcë apo të pavullnetshme të serbëve dhe joshqiptarëve të tjerë, të përpunuara nga PKDNj-ja, UNMIK-u nuk ka marrë asnjë hap në drejtim të hetimeve efektive penale, madje edhe në rastet kur UNMIK-u ishte në posedim të informacionit mbi fakte të rëndësishme të krimeve të kryera”<sup>5</sup>...

3. Koordinimi ka shprehur shqetësimin se UNMIK-u nuk ka përfshirë informacionin rreth punës së PKDNj-së apo vendimeve të saj në raportet e veta tremujore të Këshillit të Sigurimit të OKB-së,

---

<sup>4</sup> Reporti - Koordinimi i shoqatave serbe të familjeve të personave të zhdukur nga territori i ish-Jugosllavisë, 27 nëntor 2015, Konkluzionet, fq 1, par. 2a)

<sup>5</sup> Reporti - Koordinimi i shoqatave serbe të familjeve të personave të zhdukur nga territori i ish-Jugosllavisë, 27 nëntor 2015, Konkluzionet, fq. 2, par. 2b)

në të cilën raporte (PKDNj-ja) ka vënë përgjegjësinë mbi UNMIK-un për zhdukjet me forcë apo të pavullnetshme dhe vrasjet e serbëve në Kosovë dhe Metohi.

4. Koordinimi ka protestuar rreth dështimit të pretenduar vijues nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX-i Kosovë) për të filluar ose rifilluar hetimet efektive penale në çështjet e mësipërme dhe në këtë mënyrë për të sjellë para drejtësisë autorët e krimeve në fjalë.

#### **Kërkesat për UNMIK-un dhe EULEX-in Kosovë**

Koordinimi ka kërkuar që UNMIK-u të paraqesë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së një raport përmbledhës për punën e PKDNj-së në raportin e ardhshëm tremujor, posaçërisht në lidhje me ato vendime që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e UNMIK-ut për zhdukjet me forcë apo të pavullnetshme dhe vrasjeve që kanë ndodhur gjatë mandati ekzekutiv të UNMIK-ut;

Koordinimi ka kërkuar që UNMIK-u të ndërmer masa efektive, të bëjë një kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe tek EULEX-i, i cili qartas vepron nën autoritetin e Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të përfshira në vendimet e PKDNj-së si në vijim:

- a) Pranimin publik të përgjegjësisë së UNMIK-ut për shkelje të të drejtave të njeriut;
- b) Që UNMIK-u t'i nis apo t'i rinis hetimet efektive rreth krimeve të luftës në fjalë;
- c) Që UNMIK-u të krijoj një fond për të siguruar dëmshpërblim të plotë për familjet e viktimave;
- d) Që UNMIK-u të ndërmer masa për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportin e Grupit Punues rreth zhdukjeve me forcë apo të pavullnetshme.

Grupi Punues, ndër të tjera kërkon që EULEX-i Kosovë të ndërmer veprimin e nevojshme për të nisë, rinisë dhe përfunduar hetimet penale dhe për të sjellë para drejtësisë autorët e krimeve të luftës në fjalë të përshkruara në vendimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të PKDNj-së, që kjo nismë të përfshij marrjen e përgjegjësisë për këto raste të krimeve të luftës, siç janë bartur në gjyqësorin vendor;

Që qeveria e Republikës së Serbisë të përpiqet të siguroj që raporti i ardhshëm tremujor i UNMIK-ut në Këshillin e Sigurimit të OKB-së të përfshij një raport përmbledhës për punën dhe vendimet e PKDNj-së, në veçanti në lidhje me përgjegjësinë e UNMIK-ut në rastet e zhdukjeve me forcë apo të pavullnetshme dhe vrasjet, si dhe shkeljet e neneve 2 dhe 3 të KEDNj-së që kanë ndodhur gjatë mandatit ekzekutiv të UNMIK-ut;

Që PSSP-ja e UNMIK-ut të ndryshoj nenin 5 të urdhrit administrativ 2009/1, e cila ka ndryshuar Rregulloren e UNMIK 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Ky urdhër administrativ ka vënë datën 21 mars 2010 si afat për parashtrimin e ankesave pranë Panelit. Si pasojë, një numër i madh i ankuesve të cilët nuk ishin në dijeni të këtij ndryshimi nuk kanë pasur mundësi të parashtrajnë ankesa.

### **8.3. Pjesë e shkëputur nga Raporti i Human Rights Watch i vitit 2016 rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, organ i pavarur i themeluar në vitin 2009 për të shqyrtuar akuzat për shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it, ka vendosur lidhur me dy

lëndë gjatë këtij viti. Në prill Paneli ka gjetur se EULEX-i kishte shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke mos hetuar dëmin që kishin pësuar 116 romë, të cilët kishin qëndruar në një numër kampesh për personat e zhvendosur brenda vendit, ku disa ishin helmuar nga plumbi, gjatë dhe si rezultat i konfliktit të vitit 1999.

Në një rast tjetër në prill, Paneli nuk ka gjetur ndonjë shkelje të të drejtave të ankuesit që mund t'i atribuohet EULEX-it. Kjo lëndë kishte të bënte me brutalitetin e supozuar nga ana e policisë së Kosovës kundër 10 qytetarëve serbë që morën pjesë në festimet e krishtlindjeve në qytetin e Graçanicës në vitin 2013. Tridhjetë lëndë kanë qenë të pazgjidhura në Panel gjatë kohës së këtij shkrimi<sup>6</sup>.

*(SHËNIM) Në mënyrë që të përditësohet informacioni i dhënë më sipër nga Human Rights Watch, mund të theksohet se Paneli ka shqyrtuar 24 ankesa gjatë periudhës raportuese dhe ka konstatuar se EULEX-i ka bërë shkelje të të drejtave të njeriut në 4 raste. Paneli gjithashtu ka lëshuar 1 vendim mbi masa të përkohshme dhe ka shpallur 7 ankesa të papranueshme. Më tej, Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje pas përfundimit të shqyrtimit të 12 rasteve të tjera.*

*Si përmbledhje, në rastin e parë shkelja në fjalë kishte të bënte me një mosveprim nga ana e EULEX-it Kosovë, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe tri shkelje të tjera që kishin të bënin me shkeljet e shumëfishta të neneve 2, 3, 6, 8 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.*

#### **8.4. Pjesë e shkëputur nga një disertacion me titull “Përgjegjësia ndërkombëtare rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e organizatave ndërkombëtare në situatat pas konfliktit. Mësimet nga Kosova”<sup>7</sup>**

*(fq. 39 ff.)*

Prej jurisprudencës së Paneleve dalin dy trende të rëndësishme në çështjet e përgjegjësisë së organizatave ndërkombëtare në situatat pas konfliktit.

Së pari siç u theksua më herët, shumica dërrmuese e ankesave kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të obligimit pozitiv nga UNMIK-u apo EULEX-it. Në një numër vendimesh të guximshme, Panelet kanë konstatuar që (të paktën) obligimet procedurale dhe detyra e kujdesit të duhur nuk janë prekur nga kompetencat e përkohshme (të UNMIK-ut) ose të kufizuara (të EULEX-it) të organizatave ndërkombëtare (ON), e as nga vetë situata e pas konfliktit. Për më tepër, vetë Panelet tregojnë një prirje të përgjithshme drejt karakterizimit ligjor të ankesave sa i përket obligimit pozitiv, e jo atij negativ. Siç vërehet më sipër, zbatimi i qartë i ligjit të të drejtave të njeriut për ON-të në vetvete ia vlen të përmendet. Por ekzistenca - dhe shtrirja - e obligimeve pozitive të të drejtave të njeriut është i pashembullt. Sipas Paneleve këto detyrime rrjedhin nga mandati dhe

<sup>6</sup> Human Rights Watch, World Report 2016, Mosndëshkimi, Llogaridhënia dhe Qasja në drejtësi, faqe 8.

<sup>7</sup> Universiteti i Nottingham-it, Disertacioni për shkallën e masterit në juridik (LLM), LLM në të drejtën ndërkombëtare nga Alessio Gracis, MA (Trento). Shih dokumentin e plotë në: [https://www.academia.edu/22763129/International\\_Responsibility\\_for\\_Human\\_Rights\\_Violations\\_by\\_International\\_Organisations\\_in\\_Post-Conflict\\_Situations\\_Lessons\\_from\\_Kosovo](https://www.academia.edu/22763129/International_Responsibility_for_Human_Rights_Violations_by_International_Organisations_in_Post-Conflict_Situations_Lessons_from_Kosovo)

Në kohën e publikimit të Raportit Vjetor, Alessio Gracis ishte praktikant në EULEX, ku ka punuar në Zyrën për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore në Mision.

kompetencat e të dy misionëve. Duhet pranuar, situata unike e UNMIK-ut e arsyeton një qasje të tillë të zgjeruar nga PKDNj-ja. Pas vendosjes së tij të plotë dhe deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, UNMIK-u ishte në kontroll efektiv të territorit të Kosovës, ku ka ushtruar (së bashku me KFOR-in) kompetencat publike që zakonisht ushtrohen nga një shtet.<sup>8</sup> Prandaj p.sh. dështimi për të ndërmarrë një hetim efektiv në rastet e pesonave të zhdukur dhe të vrarë (nëse dëshmohen) ose dështimi për të marrë hapa pozitivë për të përmirësuar shëndetin, strehimin dhe kushtet e jetës së familjeve romë në kampet e PZhbV-së qartas kanë të bëjnë me rolin e UNMIK-ut sikur një shtet në Kosovë.

Megjithatë, jurisprudenca e PShDNj-së në lidhje me EULEX-in dëshmon se ngjashmëria me një shtet e administratës territoriale ndërkombëtar nuk është faktor vendimtar për ekzistencën e obligimeve pozitive. Në të kundërtën, ato gjithashtu mund të rrjedhin nga një mandat i cili (siç është rasti i EULEX-it) i ngarkon ON-të me kompetenca të kufizuara ekzekutive. Ndërkohë që kjo pikë do të elaborohet në kapitullin e ardhshëm, mund të thuhet përkohësisht se gjetjet e Paneleve zbatohen mutatis mutandis në të gjitha situatat në të cilat - dhe deri në masën që - operacionet për paqe ngarkohet me kompetenca administrative dhe ekzekutive të përkohshme, pa marrë parasysh se sa të kufizuara janë. Siç është vërejtur në fillim të këtij dokumenti, kjo ndodh në shumicën e operacioneve moderne të paqes.<sup>9</sup>

Trendi i dytë që del nga praktika gjyqësore e PKDNj-së dhe PShDNj-së ka të bëjë me qasjen e marrë në çështjet e atribuimit. Panelet duket se favorizojnë një qasje institucionale, në përputhje me praktikën e OKB-së. Në veçanti, në jurisprudencën e PKDNj-së atribuimi i veprimeve të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe të ON-ve të tjera UNMIK-ut janë të bazuara kryesisht në autoritetin e përgjithshëm të ushtruar në Kosovë prej UNMIK-ut nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Ndikimi i Behramit dhe Saramatit është i dukshme, por duket se PKDNj-ja është e vetëdijshme për të metat në arsyetimin e GjEDNj-së dhe ndoshta plotësisht nuk i përmbahet atyre. Çfarë është më tepër edhe pse nga perspektiva e Paneleve atribuimi nuk duket se është çështje e diskutueshme, këtu është pohuar se gjendja është potencialisht shumë më e nuancuar se çfarë sugjeron drejtpërdrejt jurisprudenca e Paneleve. Në veçanti, atribuimi i veprimeve dhe mosveprimeve nga ana e policisë së UNMIK-ut dhe EULEX-it (të cilët kanë personel të deleguar dhe në një farë mase i nënshtrohen rregullave dhe kontrollit shtetëror) mund të çojë në rezultate të kundërta, nëse gjykohet nga një gjykatë shtetërore, siç tregon rasti Nuhanovic para gjykatave holandeze.<sup>10</sup> Panelet deri tani janë shmangur që të merren drejtpërdrejt me këto çështje, edhe në saje të një karakterizimi ligjor të ankesave, si pretendimet e shkeljes së obligimeve pozitive për shkak të dështimit në kryerjen e mandatit përkatës të Misionit.

Siç është e qartë nga këto shqyrtime, të dy trendët e përshkruara kanë të bëjnë me njëra tjetrën. Ato me të vërtetë janë një kriter i 'përgjegjësisë institucionale' që përbën qëllimin kryesor të PKDNj-së dhe PShDNj-së, që do të thotë të njëjtin model të përgjegjësisë që ka shkaktuar themelimin e këtyre mekanizmave të rishikimit të brendshëm. Prandaj vetë themelimi dhe fushëveprimi i shqyrtimit të këtyre Paneleve mund të ketë stimuluar një qasje "të gjerë" drejt definicionit të obligimeve parësore, si dhe në çështjet e atribuimit që me gjasë ka rezultuar në një shtim të situatave kur UNMIK-u ose EULEX-i mund të mbahen përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. Koncepti i "përgjegjësisë institucionale" i referohet obligimeve që dalin nga vendosja e misionit, nga vendosja e një game të veçantë të objektivave dhe nga dështimi i mundshëm për të kryer ato me sukses dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut.<sup>11</sup> Këto obligime para

<sup>8</sup> Cf. Behrami dhe Saramati par. 70.

<sup>9</sup> Cf. Haeussler, 215-222.

<sup>10</sup> Kapitulli I, Pjesa C.

<sup>11</sup> Cf. Kearney et alii, 10-13.

së gjithash bien mbi ON-të udhëheqëse, qoftë OKB-ja ose BE-ja. Në lidhje me këto shkelje të të drejtave të njeriut, përgjegjësia e mundshme e shteteve kontribuuese do të duhet të jetë e bazuar në baza të ndryshme (ligjore).

(...)

Pasqyra e jurisprudencës së PKDNj-së dhe PShDNj-së përforcon mendimin - tashmë të dhënë në konkluzionet e Kapitullit I – se aspektet funksionale dhe institucionale nuk duhet të neglizhohen, kur analizohet përgjegjësia ndërkombëtare e ON-ve. Nga pikëpamja e (pazakontë) e Paneleve me mandat për të shqyrtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut të kryera nga ON-të, përgjegjësia është para së gjithash çështje e kompetencave, funksioneve dhe mandatit. Në veçanti është mandati ndërkombëtar që duhet vazhdimisht të referohet në jurisprudencën e Paneleve për të përcaktuar se çfarë janë funksionet e misionit dhe detyrat e tij pasuese dhe në çfarë mase dështimi për t'i kryer ato përben shkelje të obligimit ndaj të drejtave të njeriut që bie mbi Misionin (dhe kështu mbi ON-të). Siç vërehet më sipër, edhe pse gjendja e veçantë e Kosovës nën UNMIK-un ka pasur një rol të rëndësishëm në formimin e jurisprudencës së PKDNj-së, mundësia e dhënies së të njëjtit arsyetim për të gjitha operacionet e paqes që iu është dhënë autoritet kalimtare apo pushtet ekzekutiv është konfirmuar nga jurisprudenca e PSHDNj-së, e cila mutatis mutandis shkon në të njëjtën drejtim sa i përket veprimeve që i ngarkohen EULEX-it.

Mandati nuk i jep vetëm kompetenca kalimtare administrative apo ekzekutive ON-ve, por ai gjithashtu përcakton detyrat e ON-ve. Kështu për shembull kompetencat e UNMIK-ut për të ushtruar “të drejtën civile (...) nëpërmjet vendosjes së personelit ndërkombëtar të policisë për të shërbyer në Kosovë”<sup>12</sup> qartas përcakton detyrë për UNMIK-u që të veprojnë ashtu. Kujt i detyrohet ajo detyrë? Shteteve që kanë rënë dakord për vendosjen e tij? Organizatës apo organit të veçantë që ka krijuar atë? Shtetit mikpritës? Përgjigja në mënyrë të pashmangshme varet nga modeli i llogaridhënies në fjalë. Nga perspektiva e ligjit të të drejtave të njeriut e rëndësishme është se këto detyra i detyrohen individëve që potencialisht janë të prekur nga ushtrimi i pushtetit nga ana e ON-ve. Prandaj, kompetencat dhe detyrat bëhen pikë kryesore referimi për të përcaktuar obligimet për të drejtat e njeriut të ON-së që ushtrojnë një formë të autoritetit dhe kontrollit. Siç është thënë “është ai kapacitet për kontroll që njëkohësisht krijon një mundësi dhe një obligim për të shmangur abuzimin e të drejtave të njeriut”.<sup>13</sup>

(...)

## 9. Konkluzione

Paneli dëshiron të shfrytëzojë këtë mundësi për të tërhequr vëmendjen në disa çështje që i konsideron të rëndësishme për të ardhmen e misionit dhe se çfarë duhet të ndodhë pas tij.

Paneli konsideron se është e domosdoshme që misioni duhet të mbetet fuqimisht i përkushtuar në garantimin dhe mbrojtjen e parimeve të të drejtave të njeriut deri në fund të mandatit të tij. Ky angazhim i vazhdueshëm është thelbësor për ruajtjen e besueshmërisë së EULEX-it dhe për të siguruar që trashëgimia e tij nuk dëmtohet nga probleme të mëtejshme të reputacionit. Paneli në

<sup>12</sup> SC res 1244/1999, par. 11 (i).

<sup>13</sup> Mégret dhe Hoffman, ‘KB-ja si shkelës i të drejtave të njeriut? Disa refleksione mbi Kombet e Bashkuara që ndryshojnë përgjegjësitë mbi të drejtat e njeriut’, (2003) 25 Tremujori i të drejtave të njeriut 314, 323; gjithashtu shih kontributin e rëndësishëm të Eagleton, ‘Organizata ndërkombëtare dhe e drejta e përgjegjësisë’, (1950-51) 76 Recueil des Cours 319, 386.

këtë drejtim është inkurajuar nga përgjigja konsistente e shefit të Misionit në rekomandimet e Panelit.

Nëse Misioni për sundimin e ligjit vepron përtej afatit të tanishëm, do të jetë e domosdoshme që një mekanizëm i llogaridhënies të vazhdoj të siguroj që ky mision do të zbatohet të njëjtat standarde themelore të të drejtave të njeriut, si ato relevante për misionin e tanishëm. Një angazhim i qartë institucional për zbatimin e standardeve të tilla përmes një mekanizmi të vazhdueshëm të fortë llogaridhënës duhet të jetë pjesë thelbësore e strukturës së ardhshme të misionit.

Sa i përket një mekanizmi të tillë llogaridhënës, duhet të merren parasysh kompetencat e kufizuara *proprio motu*. Kjo do t'i mundësoj që të reagoj menjëherë për të adresuar shqetësimet e të drejtave të njeriut kur ato bëhen të dukshme në Panel pa pritur parashtrimin e një ankese formale nga një palë e prekur. Kjo do të ndihmoj që të njoftohet udhëheqësia rreth çfarëdo të metë institucionale apo të politikave që më vonë mund të kalojnë në një çështje shumë më serioze të të drejtave të njeriut. Gjithashtu do të jetë e domosdoshme që të krijohet një strukturë në kuadër të Misionit për t'iu përgjigjur dhe për të zbatuar rekomandimet e tij, siç është aktualisht Zyra për të drejtat e njeriut dhe çështje ligjore. Në lidhje me këtë, Paneli është i mendimit se është thelbësore vazhdimi i tanishëm i procedurave pasuese lidhur me rekomandimet e mekanizmit llogaridhënës.

Përveç kësaj, duhet të merret parasysh mundësia që mekanizmi llogaridhënies të ofroj dëmshpërblim financiar për individët, të cilëve u është gjetur se të drejtat e njeriut u janë shkelur nga Misioni dhe mundësisht brenda afateve të sakta që mund të përcaktohen në dokumentet mbi themelimin e ndonjë Misioni të ri. Paneli mendon se kjo do të rrisë efektivitetin e mekanizmit të llogaridhënies, se do të kontribuojë pozitivisht në reputacionin e Misionit dhe të ofroj mjetin efektiv juridik që aktualisht zbatohet në Panel.

Sa i përket çfarëdo misioni të ardhshëm, duhet të kryhet një analizë e kategorive të rasteve në të cilat janë gjetur shkelje të të drejtave të njeriut e që do të jenë të rëndësishme dhe ndihmuese për planifikimin dhe strukturimin ligjor të ndonjë Misioni të ardhshëm. Masat e duhura dhe efektive mbrojtëse mund të ndërtohet rreth mësimëve që janë nxjerrë nga përvoja e këtij Misioni.

Nëse Misioni nuk e vazhdon mandatin e tij përtej afatit të tanishëm, është thelbësore që të krijohet një mekanizëm i përshtatshëm, i cili do t'i lejoj Panelit të vazhdoj të përmbushë mandatin e tij për një periudhë të caktuar kohore, deri në masën e nevojshme për përpunimin e ankesave të bëra në një afat gjashtë mujor dhe për përfundimin e shqyrtimit të ankesave që janë ende duke u përpunuar. Kjo nënkupton jo vetëm vazhdimin e ekzistencës së Panelit (dhe disponueshmërinë e personelit), por edhe disponueshmërinë e personelit kompetent brenda një mekanizmi të mbetur për t'iu përgjigjur dhe adresuar kërkesave të Panelit.

Paneli është i mendimit se të gjitha vendimet e tij, ku janë gjetur se ka pasur shkelje duhet të sillen në vëmendjen e personelit për qëllime të trajnimit dhe për të shmangur shkeljet e ngjashme që ndodhin në të ardhmen. Përveç kësaj, Misioni duhet të ofroj trajnim rreth standardeve të përbashkët të të drejtave të njeriut për të gjithë anëtarët e Misionit, të cilët vijnë nga vende të ndryshme me kultura të ndryshme ligjore, përmes programeve të përshtatshme të trajnimit.

Gjithashtu Paneli nënvizon lidhjen e qartë që ekziston midis sigurisë dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut. Në mungesë të një ambienti të sigurt në të cilën çdo individ ndihet i sigurt për të jetuar jetën e tij ose të saj nuk ka mundësi të përparojnë të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Prandaj është e domosdoshme që angazhimi i fortë i BE-së të integrohet në politikën e tij të përgjithshme të sigurisë në Kosovë ndaj të drejtave të njeriut, në veçanti sa i përket gjendjes në veri të Kosovës. Duhet të përkrahët dhe zgjerohet mbështetja për përpjekjet vendore - në veçanti përmes gjyqësorit - për të krijuar një ambient të fortë të sundimit të ligjit.



Paneli është i angazhuar që mbrojtja e pakicave duhet të mbetet prioritet i rëndësishëm për Misionin, për BE-në dhe autoritetet vendore. Të drejtat e njeriut duhet të garantohen pa dallim etnie, feje apo kombësie. Diskriminimi në bazë të kriterëve të tilla duhet të luftohet në mënyrë efektive dhe duhet të eliminohet nga të gjitha nivelet institucionale dhe politike. Paneli konsideron se një angazhim për t'i dhënë fund dhe luftuar diskriminimet e tilla në Kosovë duhet të jetë karakteristikë thelbësor për të ardhmen e Misionit.

## SHTOJCA 1 Tabela e personelit

<b>Paneli</b>	
<b>Magda Mierzevska</b>	Kryesuese e Panelit
<b>Guénaël Mettraux</b>	Anëtar i Panelit
<b>Katja Dominik</b>	Anëtare e Panelit, gjykatëse e EULEX-it
<b>Elka Filcheva-Ermenkova</b>	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it

<b>Sekretariati</b>	
<b>John J. Ryan</b>	Zyrtar i lartë ligjor nga muaji prill 2010 deri më dhjetor 2014
<b>Joanna Marszalik</b>	Zyrtare ligjore
<b>Paul Landers</b>	Zyrtar ligjor nga muaji shtator 2012 deri në dhjetor 2014
<b>Shpresa Gosalci</b>	Asistente administrative/gjuhësore (shqip-anglisht)
<b>Katica Kovacevic</b>	Inteprete/përkthyes (serbisht-anglisht)
<b>Kushtrim Xhaferi</b>	Interpret/përkthyes (shqip-anglisht)

## SHTOJCA 2 Statistikat 2010 - 2015

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej
<b>Lëndët e regjistruara - Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>28</b>	<b>23</b>	<b>27</b>	<b>42</b>	<b>16</b>	<b>152</b>
<b>Lëndët e përfunduara - Gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>30</b>	<b>10</b>	<b>20</b>	<b>28</b>	<b>27</b>	<b>121</b>
Të pranueshme			2		1	<b>8</b>	<b>11</b>
Të papranueshme	6	22	10	13	22	<b>12</b>	<b>85</b>
Shkelje	0	2	0	7	2	<b>4</b>	<b>15</b>
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	1	<b>10</b>	<b>16</b>
Të hequra në lista	0	1	0	0	3	<b>1</b>	<b>5</b>

	<b>Me 31 dhjetor 2015</b>
Lëndët jo të përfunduara	31
Të komunikuar te ShM	15

### SHTOJCA 3 Vendimet e PShDNj-së 2010-2014

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-01	Djeljalj Kazagic	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2010-02	Sadik Thaqi	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-03	Osman Mehmetaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-04	Feti Demolli	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-05	Mursel Hasani	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-06	Latif Fanaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-07	Blerim Rudi	Dyshohet në mos zbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare	Shkelje
2010-08	Delimir Krstic	Dyshohet në mos veprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
2010-09	Burim Ramadani	Dyshohet në mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-13	Një punëtor i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme

<b>2010-14</b>	Lulzim Gashi	Kandidim jo i suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
<b>2010-15</b>	Faton Sefa	Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), dyshohet në mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
<b>2010-16</b>	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i drejtë i lëndës së ankueses nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-01</b>	Familja e Dedë Gecaj	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
<b>2011-02</b>	Chamalagai Krishna Bahadur	Dyshohet në mos veprim	E papranueshme
<b>2011-03</b>	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
<b>2011-04</b>	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista e ankesave
<b>2011-05</b>	SH.P.K "Syri"	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC	E papranueshme
<b>2011-06</b>	Milazim Blakqori	Dyshohet në moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-07</b>	Lënda W	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2011-08</b>	Anton Rruka	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC	E papranueshme
<b>2011-09</b>	Mirkovic Bojan	Dyshohet në largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-10</b>	Dejan Jovanovic	Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave në SCSC	E papranueshme
<b>2011-11</b>	Srecko Martinovic	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-12</b>	Novica Trajkovic	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme
<b>2011-13</b>	S.M.	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për	E papranueshme

		gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	e
<b>2011-14</b>	Lindita Shabani	Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
<b>2011-15</b>	Samedin Smajli	Dyshohet në mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-16</b>	Avdyl Smajli	Dyshohet në mohim të gjyqimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
<b>2011-17</b>	Faik Azemi	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2011-18</b>	Mykereme Hoxha	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-19</b>	Sefer Sharku	Dyshohet në mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor	E papranueshme
<b>2011-21</b>	Ventor Maznikolli	Dyshohet në vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme	E papranueshme
<b>2011-22</b>	Hysni Gashi	Dyshohet në mohim të një gjykimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësi të gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
<b>2011-23</b>	Hashim Rexhepi	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
<b>2011-24</b>	Predrag Lazic	Dyshohet në mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm	E papranueshme
<b>2011-25</b>	Shaip Gashi	Dyshohet në privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi	E papranueshme
<b>2011-26</b>	Njazi Asllani	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	E papranueshme
<b>2011-28</b>	Lënda Y	Dyshohet në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.	E papranueshme
<b>2012-01</b>	Qamil Hamiti	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-02</b>	Arben Zeka	Dyshohet në mos gjykim të një lënde pronësore	E papranueshme
<b>2012-03</b>	Rexhep Dobruna	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme

<b>2012-04</b>	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë	E papranueshme
<b>2012-05</b>	Fatmir Pajaziti	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë	E papranueshme
<b>2012-06</b>	Lënda Z	Dyshohet në shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së	E papranueshme
<b>2012-07</b>	Lënda I	Dyshohet në mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
<b>2012-08</b>	Lënda U	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-09</b>	Lënda A	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-10</b>	Lënda B	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-11</b>	Lënda C	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-12</b>	Lënda D	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-13</b>	Bejtush Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-15</b>	Shefqet Emerllahu	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim	E papranueshme
<b>2012-16</b>	Kristian Kahrs	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
<b>2012-17</b>	Lënda E	Dyshohet në shkelje të nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-18</b>	Hamdi Sogojeva	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2012-19</b>	Lënda H	Dyshohet në konfiskim të pronës	Shkelje
<b>2012-20</b>	Lënda G	Dyshohet në shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2012-21</b>	Mirko Krlic	Dyshohet në shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së	Nuk ka shkelje
<b>2012-23</b>	Predrag Blagic	Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave

<b>2013-01</b>	Lënda I	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-02</b>	Arsim Krasniqi	Dyshohet në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-03</b>	Goran Becic	Dyshohet në shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2013-04</b>	J	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-15</b>	Gani Zeka	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-16</b>	Almir Susaj	Dyshohet në shkelje të nenit 3 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-17</b>	Ramadan Rahmani	Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-18</b>	Jovanka, Dragan, Milan Vukovic	Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-19</b>	U	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-20</b>	Shaip Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-22</b>	Gani Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-23</b>	V	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-24</b>	Emin Maxhuni	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-25</b>	Milorad Rajovic	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-26</b>	Selami Taraku	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2013-27</b>	Shaban Kadriu	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-01</b>	Nexhat Qubreli	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme



		së	e
<b>2014-03</b>	Lënda A.Z.	Dyshohet në shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave
<b>2014-04</b>	Tomë Krasniqi	Dyshohet në shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-06</b>	Lënda B.Y.	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-07</b>	Fitore Rastelica	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-08</b>	C.X.	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-09</b>	Rifat Kadribasic	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-19</b>	Fahri Rexhepi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-20</b>	Mensur Fezaj	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-21</b>	Shefki Hyseni	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 KEDNj-së	E hequr nga lista e ankesave
<b>2014-22</b>	Ismajl Krapci	Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-23</b>	Shaip Selmani	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-25</b>	Nuha Beka	Kontest punësimi	E papranueshme
<b>2014-28</b>	Selatin Fazliu	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-03</b>	Lënda A.Z.	Dyshohet në shkeljen e neneve 3, 8 dhe 13 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-04</b>	Tomë Krasniqi	Dyshohet në shkeljen e nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 KEDNj-së, neni 1 i protokollit nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-05</b>	Mazlam Ibrahimimi	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-06</b>	Lënda B.Y.	Dyshohet në shkeljen e Nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshm

			e
<b>2014-07</b>	Fitore Rastelica	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-08</b>	C.X.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-09</b>	Rifat Kadribasic	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-18</b>	Fitim Maksutaj	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2014-19</b>	Fahri Rexhepi	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-20</b>	Mensur Fezaj	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-21</b>	Shefki Hyseni	Dyshohet në shkeljen e nenit 5 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-22</b>	Ismajl Krapci	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-23</b>	Shaip Selmani	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-24</b>	Lënda J.Q.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-25</b>	Nuha Beka	Kontest në punë	E papranueshme
<b>2014-28</b>	Selatin Fazliu	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-26</b>	Ajet Kaçiu	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-27</b>	Qerim Begolli	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-29</b>	Shemsi Musa	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-30</b>	Abdilj Sabani	Dyshohet në shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-31</b>	Lënda K.P.	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

<b>2014-32</b>	L.O.	Dyshohet në shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
<b>2014-33</b>	Arben Krasniqi	Dyshohet në shkeljen e nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-38</b>	Slavica Mikic	Dyshohet në shkeljen e nenit 13 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-40</b>	Avni Hajdari	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E hequr nga lista
<b>2014-41</b>	Liridona Mustafa Sadiku	Dyshohet në shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
<b>2014-42</b>	Bujar Zherka	Dyshohet në shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

## SHTOJCA 4 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera

	Data	Vendi	Ngjarja	Paneli	Sekretariat i	Organizata
1	20/05/15	Zyra e PShDNj-së	Takim me z. Roland Bless, shef i Zyrës për Informim të EULEX-it	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova	Joanna Marszalik	
2	21/05/15	Zyrat e EULEX-it Chicken Farm Building	Takim me z. Alban Ragg, shef i policisë ekzekutive dhe komandant i EXPOL-it	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova	Joanna Marszalik & John Ryan	
3	07/05/15	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Mitrovicë e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, kordinatore e zyrës për Kosovë dhe Metohi, Daniela Milic, zyrtare e zyrës për Kosovë dhe Metohi		John Ryan & Katica Kovacevic	
4	07/05/15	Zyra e PShDNj-së	Takim me Mbështetje për zbatimin e strategjive për PZhBV-së, refugjatët dhe të kthyerit, Massimo Moratti & Rastko Brajkovic		Joanna Marszalik	
5	19/05/15	Kisha ortodokse serbe, Istog	Takim me atin Milos dhe atin Nebojsa		John Ryan & Katica Kovacevic	
6	27/05/15	Zyra e UNHCR-së, Prishtinë	Takim me z. Narasimha Rao, shef i Misionit të UNHCR-së, Kosovë		John Ryan & Kushtrim Xhaferi	
7	16/06/15	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Mitrovica	Takim me znj. Zlata Radovanovic, kordinatore e zyrës për Kosovë dhe Metohi	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja	John Ryan, Joanna Marszalik & Katica Kovacevic	

		e veriut		Dominik, Elka Filcheva- Ermenkova		
8	24/06/15	Villa Gërmia, Prishtinë	Diskutim në tryezën e rrumbullakët rreth temës “Trotuaret dhe ndikimi i tyre në të drejtat e njeriut”.		John Ryan & Shpresa Gosalci	Avokati i popullit, Handikos, Rec, Komuna e Prishtinës, Policia.
9	24/06/15	Avokati i popullit, Prishtinë	Takim me z. Sami Kurteshin, Avokat i popullit		John Ryan & Kushtrim Xhaferi	
10	28/07/15	Avokati i popullit, Prishtinë	Takim me z. Hilmi Jasharin, Avokat i popullit		John Ryan, Joanna Marszalik & Kushtrim Xhaferi	
11	01/10/15	Zyra për Kosovë dhe Metohi, Mitrovica e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, kordinatore e zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe Bratislava Radovanovic, (BR) zyrtare e zyrës për Kosovë dhe Metohi		John Ryan, Paul Landers & Katica Kovacevic	
12	19/10/15	Shoqata për persona të zhdukur dhe të rrëmbyer, Beograd, Serbi	Takim me Olivera Gazikalovic, kordinatore e Shoqatës, Olgica Bozovic, anëtare, Dushko Celic, anëtar, dhe Verica Tomanovic, anëtare e Shoqatës për persona të zhdukur he të rrëmbyer		Paul Landers & Katica Kovacevic	
13	20/10/15	Komisioni për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer, Qeveria e Republikë s së Serbisë	Takim me Vesna Boshkovic, kordinatore e Komisionit, dhe Dragan Jenic, shef i Zyrës së Komisionit për personat e zhdukur dhe të rrëmbyer		Paul Landers & Katica Kovacevic	
14	21/10/15	Projekti për ndihmë	Takim me Rastko Brajkovic dhe Milena Sosic, zyrtarë ligjorë		Paul Landers & Katica	

		juridike për PZhBV-të, Beograd, Serbi	të projektit për ndihmë juridike për PZhBV-të		Kovacevic	
15	29/10/15	Hoteli Sirius, Prishtinë	Konferencë bashkë-organizuar nga "Drejtësi dhe Fushata e popullit" dhe Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese		John Ryan & Kushtrim Xhaferi	
16	09/11/15	Vidane, Komuna e Klinës	Takim me Bozhidar Sharkovic, kryetar i komunës së Klinës, Ivan Popovic, autoriteti i përkohshëm dhe Vesna Peshic, sekretar, komuna e Klinës		John Ryan & Katica Kovacevic	
17	12/11/15	Zyra e PShDNj-së, Prishtinë	Takim me z. John Rouse, shefi i kabinetit të EULEX-it Kosovë	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova	John Ryan, Joanna Marszalik & Paul Landers	
18	19/11/15	Vidane, Komuna e Klinës	Takim me Bozhidar Sharkovic, kryetar, Komuna e Klinës, Vuleta Vostic, Mihajlo Cekrlc dhe Vladimir Radosavlevic, përfaqësues të fshatit Dërsnik, Klinafc, komuna e Klinës		John Ryan & Katica Kovacevic	
19	23/11/15	Hoteli Emerald	Pritje - 15 vjetori i themelimit të Institucionit të Avokatit të popullit të Kosovës		John Ryan & Kushtrim Xhaferi	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
20	07/11/15	Nemanjin a 11, Beograd, Serbi	Igor Popovic, shef i Grupit për Drejtësi, të Drejta të Njeriut dhe të Drejta në Pronësi, Zyra për	Magda Mierzewska, Guenael Mettraux, Katja	John Ryan, Joanna Marszalik, Paul Landers &	

			Kosovë dhe Metohi, Sllobodanka Babic, këshilltare, Departamenti i Çështjeve Ligjore, Zyra për Kosovë dhe Metohi, Dragan Jenic, Kryetari i Komisionit për Persona të Zhdukur dhe Vesna Boskovic, kordinatore, Zyra për Persona të Zhdukur, Qeveria e Republikës së Serbisë	Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova	Katica Kovacevic	
21	08/11/15	Hotel Moska, Beograd, Serbi	Takim me Rastko Brajkovic, Këshilli Danez për Refugjatë [(më parë Projekti për Mbështetje të mëtejshme të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Serbi, (EuropeAid/129209/C/SER/RS)]	Magda Mierzewska, Katja Dominik, Elka Filcheva-Ermenkova	John Ryan, Joanna Marszalik, Paul Landers & Katica Kovacevic	